

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS

RAPORTI I VITIT 2020



DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës u krijuan në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, një amendamenti kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Ato janë të përkohshme dhe me mandat dhe juridiksion të përcaktuar për krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera të përkufizuara sipas ligjeve të Kosovës, të cilat pretendohen se kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë nga 1 janari i vitit 1998 deri më 31 dhjetor të vitit 2000 nga, apo kundër qytetarëve të Kosovës, apo të ish-Republikës Federative të Jugosllavisë.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës kanë një seli në Hagë, Holandë. Personeli i tyre që përfshin edhe gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe Administratoren, është ndërkombëtar.

**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA
E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË
KOSOVËS**

RAPORTI I VITIT 2020




**DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS**

Përmbajtja

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS	5
Parathënie	6
Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në	8
Masat e KOVID-19	16
DHOMAT	20
1. Aktivitetet gjyqësore	21
2. Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve	27
3. Aktivitetet e jashtme të Kryetares	30
MARRËDHËNIET ME JASHTË	32
1. Marrëdhëniet me jashtë	33
ZYRA ADMINISTRATIVE	34
1. Kabineti i Administratores	39
2. Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun	40
2.1. Marrëdhëniet me mediat	41
2.2. Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim	42
2.3. Vizitat në DHSK	44
2.4. Informacioni publik për DHSK-në	45
3. Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	46
4. Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore	47
4.1. Njësia për Administrimin e Gjykatës	47
4.2. Njësia e Përkthimit	48
4.3. Zyra e Mbrojtjes	49
4.4. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave	51
4.5. Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve	52
4.6. Njësia e Paraburgimit	52
5. Seksioni i Administratës	54
5.1. Njësia e Burimeve Njerëzore	54
5.2. Njësia e Teknologjisë së Informacionit	57
5.3. Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme	58
5.4. Njësia e Sigurisë	59
5.5. Njësia e Financave dhe Buxhetit	60
5.6. Njësia e Prokurimit	61
6. Zyra e Auditimit	62
INTEGRIMI I PERSPEKTIVËS GJINORE NË DHSK DHE ZPS	64
1. Personi i kontaktit për çështje gjinore	65
2. Politika proaktive e DHSK-së dhe ZPS-së në lidhje me barazinë gjinore	66
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR	69
1. Parathënie	70
2. Zbatimi i mandatit	71
3. Historiku i ZPS-së	74
4. Kuadri udhëheqës i Prokurorisë	75

Dhomat e Specializuara të Kosovës



Është kënaqësi e madhe për ne t'ju paraqesim raportin vjetor të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) për vitin 2020. Viti i kaluar ishte i jashtëzakonshëm në më shumë aspekte. Atë e shënuan disa arritje të rëndësishme për DHSK-në, ndër të cilat fillimi i proceseve gjyqësore dhe arrestimi i të akuzuarve, edhe atë në rrethana të pandemisë që ndryshoi thelbësisht jetën tonë profesionale dhe personale. Andaj, nuk mund të raportojmë për veprimtaritë e intensifikuara të këtij viti pa përmendur vështirësitë që shkaktoi pandemia e KOVID-19. Dëshirojmë t'u shprehim ngushëllimet tona më të sinqerta të gjithë atyre që pësuan humbje personale si rezultat i pandemisë, si dhe mirënjohjen tonë të thellë të gjithë punonjësve për vendosmërinë dhe profesionalizmin e tyre.

Pas hetimeve intensive dhe shtimit të numrit të fletëhirrjeve në vitin 2019, Prokurori i Specializuar, së pari në shkurt dhe më pas në prill 2020, njoftoi Kryetaren e DHSK-së se kishte ndërmend të niste procedime penale. Me paraqitjen e aktakuzave nga Prokurori i Specializuar, DHSK-ja hyri në një fazë të re të rëndësishme. Në dy aktakuzat, më shumë persona – nga Presidenti i atëhershëm i Kosovës e deri tek komandanti i një njësie të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ka vepruar gjatë periudhës përkatëse – akuzohen për kryerje të një numri krimesh lufte dhe krimesh kundër njerëzimit. U caktua Gjykatësi i Procedurës Paraprake, i cili konfirmoi dy aktakuzat dhe filloi procedurën paraprake në të dy çështjet gjyqësore. Siç mund të shihet, përkundër rrethanave të KOVID-19, puna gjatë vitit 2020 jo vetëm që vazhdoi me ritmin e deriatëhershëm, por edhe dukshëm u intensifikua.

Siguria dhe mbrojtja e dëshmitarëve janë të rëndësishme parësore për DHSK-në, ashtu siç është edhe integriteti i proceseve gjyqësore të saj. Për këtë qëllim, dy persona u arrestuan në Kosovë dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë në bazë të dyshimit se kanë kryer vepra

penale kundër administrimit të drejtësisë. Aktakuza në atë çështje është konfirmuar dhe kundër tyre ka filluar procedura paraprake.

DHSK-ja zhvilloi edhe aktivitete të tjera gjyqësore. Në prill, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren vjetore përmes videokonferencës, në të cilën gjykatës Çarls Smith III u zgjodh nënkryetar dhe u miratuan ndryshimet e Rregullores së Procedurës dhe të Provave. Gjithashtu, edhe Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese dhe paneli i Gjykatës së Apelit u angazhuan në një sërë çështjesh gjyqësore gjatë vitit 2020.

Ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim nuk ishte më pak produktiv dhe u përshtat shpejt me rrethanat e reja të krijuara nga pandemia. Në kuadër të këtij Programi u organizuan veprimtari të shumta përmes videokonferencës, si dhe takime me përfaqësues të ndryshëm të shoqërisë civile kosovare. Në të njëjtën frymë, DHSK-ja mbajti takimin e katërt të Rrjetit të informimit të gjykatës. Në takim morën pjesë trembëdhjetë OJQ, të cilat dhanë mendime të vyera në lidhje me përmbajtjen dhe efikasitetin e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të gjykatës.

Zhvillimet në DHSK gjatë vitit të kaluar vetëm se zgjuan interes edhe më të madh për aktivitetet e saj. Për ne është me rëndësi që të gjithë të interesuarit në punën e DHSK-së të mund të kenë lehtësisht qasje në informacion të paanshëm, dhe mbesim të përkushtuar që publiku të informohet në mënyrë transparente dhe efikase për të gjitha zhvillimet relevante. Për këtë qëllim, seancat publike transmetohen drejtpërsëdrejti në faqen e DHSK-së në Internet, në tri gjuhët zyrtare të gjykatës. Ne u kushtojmë rëndësi të madhe marrëdhënieve që kemi me komunitetet në Kosovë dhe jemi mirënjohës për mendimet që marrim rregullisht nga përfaqësuesit e shoqërisë civile kosovare, qoftë në formë të pyetjeve nga gazetarët apo komenteve në lidhje me Programin për komunikim dhe ndërgjegjësim.

Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim i gjykatës u mundësua në sajë të mbështetjes financiare zemërgjerë të qeverisë zvicerane, së cilës i jemi shumë mirënjohës.

Arritjet tona gjatë vitit 2020 nuk do të ishin të mundshme pa mbështetjen e vazhdueshme të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shteteve të treta kontribuese. Gjithashtu i jemi mirënjohës Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë për mbështetjen e paçmueshme gjatë operacioneve komplekse, si dhe policisë së Kosovës për ndihmën e tyre në këtë aspekt.

Falënderojmë gjithashtu kolegët tanë në Shërbimin Evropian për Veprim të Jashtëm, në Shërbimin e Komisionit Evropian për Instrumentet e Politikës së Jashtme dhe në Zyrën për Planifikim dhe Drejtim Civil, për ndihmën dhe bashkëpunimin e tyre gjatë vitit 2020.

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Hagë, dhjetor 2020

Gjithashtu u shprehim mirënjohje shteteve, trupit diplomatik, si edhe gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë dhe të ndërkombëtarizuar në Hagë, për bashkëpunimin dhe shkëmbimet e rregullta konstruktive në lidhje me çështje organizative dhe administrative.

Kemi pasur një vit intensiv, përplot me arritje të rëndësishme, dhe jemi veçanërisht mirënjohës ndaj punonjësve tanë, të cilët vazhduan të punojnë në përputhje me standardet më të larta, me gjithë vështirësitë që shkaktoi pandemia e KOVID-19. Përkushtimi dhe profesionalizmi i palëkundshëm i tyre i bënë të mundshme arritjet tona.

E mirëpresim vitin që kemi përpara, në të cilin DHSK-ja do të hyjë në një fazë të re të proceseve gjyqësore, të cilat do të vazhdojnë t'i kryejë në mënyrë të sigurt, të pavarur, të paanshme, të drejtë dhe efikase, në përputhje me mandatin e vet.

Dr. Fidelma Donlon
Administratore e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Një vështrim i shpejtë mbi DHSK-në

Në qershor të vitit 2008, Komisioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut emëroi një raportues të posaçëm për hetimin e pretendimeve për krime të rënda të kryera gjatë dhe pas konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë.

Në **janar 2011**, me Rezolutën 1782 (2011), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e përgatitur nga raportuesi i posaçëm (Raporti i Këshillit të Evropës) në të cilin pretendohet se ishin kryer krime të shumta kundër serbëve, shqiptarëve të Kosovës të dyshuar si bashkëpunëtorë të regjimit serb, si dhe kundër personave të tjerë.

Në vijim të Raportit të Këshillit të Evropës, në **maj 2011**, shtetet anëtare të BE-së e shqyrtuan çështjen në kuadër të Komisionit Politik dhe të Sigurisë – organ që merret me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian. Pas kësaj u themelua Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e cila u ngarkua me detyrën e kryerjes së hetimeve të pavarura të pretendimeve për ndalim të paligjshëm, dëbim, akte çnjerëzore, torturë dhe vrasje, si dhe për krime të tjera që lidhen me Raportin e Këshillit të Evropës. Me seli në Bruksel, TFHS-ja filloi punën në **shtator 2011**.

Ndërkohë që vazhdonin hetimet, përmes Shkëmbimit të Letrave midis Presidentes së Kosovës dhe Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe të sigurisë, në **prill 2014**, u arrit një marrëveshje ndërkombëtare për themelimin dhe funksionimin e dhomave të veçanta gjyqësore për ndjekjen penale të krimeve që mund të rezultojnë nga hetimet e TFHS-së.

Shkëmbimi i Letrave përcakton se këto dhoma të veçanta gjyqësore do të themeloheshin në përputhje me ligjin e Kosovës. Këto dhoma gjyqësore dhe zyra e prokurorit të specializuar do të kishin statutin dhe rregulloren e tyre të procedurës dhe provave, dhe do

të përbëheshin vetëm nga punonjës dhe drejtues ndërkombëtarë. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet gjithashtu se dhomat e veçanta gjyqësore do të kishin seli në një shtet të tretë dhe se procedurat e ndjeshme, duke përfshirë dëgjimin e dëshmitarëve, do të mbaheshin jashtë Kosovës. Shkëmbimi i Letrave u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave në prill 2014 dhe u bë pjesë e legjislacionit të brendshëm. Ai ka epërsi ndaj ligjeve të Kosovës.

Në **korrik 2014**, kryeprokurori i TFHS-së bëri një deklaratë në të cilën thuhej se “TFHS-ja është në gjendje të ngrejë aktakuzë ndaj disa zyrtarëve të lartë të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Në **mars 2015**, Kryetari i Kuvendit të Kosovës i referoi Gjykatës Kushtetuese të Kosovës amendamentin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e Shkëmbimit të Letrave. Sipas Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës duhej të vlerësonte nëse amendamenti i propozuar pakësonte të drejtat dhe liritë e garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës. Në **prill 2015**, Gjykata Kushtetuese e Kosovës shpalli se amendamenti i propozuar ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës dhe se “struktura, fushëveprimi i juridiksionit dhe funksionimi i Dhomave të Specializuara do të rregullohen me ligje të mëtejshme, në përputhje me Kushtetutën”.

Ky amendament hyri në fuqi me anë të nenit 162 të Kushtetutës së Kosovës, që u miratua nga Kuvendi i Kosovës në **gusht 2015**. Në të njëjtën kohë u miratua edhe Ligji për themelimin e dy institucioneve, që është instrumenti themeltar i Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në **prill 2016**, dr. Fidelma Donlon u emërua Administratore e Dhomave të Specializuara, çka shënon fillimin e punës së Zyrës Administrative të DHSK-së në Hagë.

Në **shtator 2016**, Dejvid Shvendiman (David Schwendiman) u emërua Prokuror i Specializuar.

Në **dhjetor 2016**, gjykatëse Ekaterina Trendafilova u emërua Kryetare e DHSK-së dhe filloi punën në janar 2017.

Më **1 janar 2017**, hyri në fuqi Marrëveshja me shtetin pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në territorin e Holandës.

Pas kësaj, në **shkurt 2017**, nëntëmbëdhjetë gjykatës u emëruan në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë të Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në **mars 2017**, në plenaren e parë, gjykatësit e DHSK-së miratuan Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.

Pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, Rregullorja e Procedurës dhe e Provave hyri në fuqi në **korrik 2017**, duke e bërë DHSK-në plotësisht funksionale në aspektin gjyqësor.

Në **nëntor 2017**, Administratorja miratoi Direktivën për Mbrojtësit, e cila, ndër të tjera, përcakton kriteret e përzgjedhjes së mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave në DHSK. Që atëherë, 199 juristë nga Kosova, Serbia dhe një numër vendesh të tjera, janë pranuar në Listën e mbrojtësve të specializuar dhe mbrojtësve të viktimave.

Në **maj 2018**, Pjetro Spera u emërua Avokat i Popullit i DHSK-së.

Në **qershor 2018**, u ngrit Rrjeti i informimit të gjykatës, që përfshin OJQ vendore nga Kosova dhe Serbia.

Në **shtator 2018**, pas Dejvid Shvendimanit, në postin e Prokurorit të Specializuar u emërua Xhek Smith (Jack Smith).

Në **mars 2019**, gjykatësit e DHSK-së mbajtën plenaren e katërt. Në të njëjtin muaj, u miratua Kodi i Etikës Profesionale për Mbrojtësit dhe Prokurorët para DHSK-së.

Në **qershor 2019**, DHSK-ja dhe ZPS-ja u zhvendosën në mjediset e reja.

Në **shkurt dhe prill 2020**, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzat e para.

Në **prill 2020**, Administratorja Fidelma Donlon u riemërua edhe për një mandat katërvjeçar.

Në **shtator 2020**, bënë betimin gjashtë gjykatës të rinj, Prokurori i Specializuar arrestoi të akuzuarin e parë, z. Salih Mustafa, mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.

Në **nëntor 2020**, Prokurori i Specializuar arrestoi z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Në **dhjetor 2020**, Kryetarja Ekaterina Trendafilova u riemërua për një mandat katërvjeçar.

Kronologji



JANAR 2011

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (KiE) miraton Raportin mbi "Trajtimin çnjerëzor të personave dhe trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore në Kosovë".

SHTATOR 2011

Fillon punën Task Forca Hetimore Speciale (TFHS), e ngritur nga BE-ja për kryerjen e hetimeve penale në lidhje me pretendimet në Raportin e KiE-së.

PRILL 2014

Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe të sigurisë shkëmbejnë letra në lidhje me krijimin e "dhomave të veçanta gjyqësore".

GUSHT 2015

Kuvendi i Kosovës miraton nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

JANAR 2017

Hyn në fuqi Marrëveshja me shtetin pritës midis Kosovës dhe Holandës, që i mundëson DHSK-së kryerjen e procedurave penale në Holandë.



DHJETOR 2016

Gjykatëse Ekaterina Trendafilova emërohet Kryetare e DHSK-së.

SHTATOR 2016

Dejvid Shvendiman emërohet Prokuror i Specializuar.



PRILL 2016

Dr. Fidelma Donlon emërohet Administratore e DHSK-së, çka shënon fillimin e punës së institucionit gjyqësor në Hagë.



SHKURT 2017

Emërohen 19 gjykatës në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë.

MARS 2017

Gjykatësit miratojnë Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, e cila më pas shqyrtohet nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës.

KORRIK 2017

Hyn në fuqi Rregullorja e Procedurës dhe e Provave pas vlerësimit të kushtetutshmërisë së saj nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, dhe DHSK-ja bëhet funksionale në aspektin gjyqësor.

NËNTOR 2017

Administratorja miraton Direktivën për Mbrojtësit, e cila përcakton kriteret për përzgjedhjen e mbrojtësve për përfaqësimin e të dyshuarve, të akuzuarve dhe viktimave para DHSK-së.



QERSHOR 2019

DHSK-ja dhe ZPS-ja zhvendosen në mjediset e reja.



SHTATOR 2018

Xhek Smith emërohet Prokuror i Specializuar pas Dejvid Shvendimanit.



MAJ 2018

Pjetro Spera emërohet Avokat i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës.

Kronologji

SHKURT DHE PRILL 2020

Prokurori i Specializuar paraqet aktakuzat e para.



PRILL 2020

Administratorja Fidelma Donlon rimërohet edhe për një mandat katërvjeçar.



DHJETOR 2020

Kryetarja Ekaterina Trendafilova rimërohet për një mandat katërvjeçar.

NËNTOR 2020

Prokurori i Specializuar arreston z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi mbi bazën e akuzave për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.



SHTATOR 2020


Gjashtë gjykatës të rinj bëjnë betimin dhe Prokurori i Specializuar arreston z. Salih Mustafa mbi bazën e akuzave për krime lufte, si dhe z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj mbi bazën e akuzave për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.



Wear face mask
Mbjajeni maskën mbrojtëse m fytyrë
Nosite masku



Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) janë dy institucione të pavarura të ngritura pas Shkëmbimit të Letrave në përputhje me ligjin e Kosovës, me anë të amendamentit kushtetues në 2015. Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) u miratua nga Kuvendi i Kosovës në gusht 2015.



■ Mandati i DHSK-së është

- “garantimi i procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës [...] dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të Task Forcës Hetimore Speciale” (neni 1 i Ligjit).

■ DHSK-ja është krijuar në përputhje me Shkëmbimin e Letrave dhe ligjin e Kosovës, dhe

- ka të njëjtat shkallë gjykimi si sistemi gjyqësor i Kosovës (themelore, e apelit, supreme, kushtetuese).
- ka seli jashtë Kosovës
- përbëhet nga gjykatës dhe punonjës që janë shtetas të shteteve anëtare të BE-së ose të shteteve të treta kontribuese
- zbaton të drejtën zakonore ndërkombëtare dhe të drejtën penale materiale të Kosovës sikundër parashikohet në Ligj
- zbaton rregullat e veta të procedurës dhe provave.

■ DHSK-ja është një institucion gjyqësor i përkohshëm


- ajo do të ekzistojë vetëm për sa kohë që do të jetë e nevojshme për gjykimin e akuzave të paraqitura nga Prokurori i Specializuar dhe deri sa Këshilli i BE-së të njoftojë Kosovën për përfundimin e hetimeve dhe proceseve gjyqësore.

■ Juridiksioni i DHSK-së përfshin

- krime kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime të tjera sipas të drejtës penale të zbatueshme në kohën kur janë kryer krimet
 - që kanë ndodhur midis 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000
 - që kanë filluar të kryhen apo janë kryer në Kosovë, ose që janë kryer nga persona me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë, ose ndaj personave me shtetësi të Kosovës/Republikës Federale të Jugosllavisë
- vepra penale të caktuara kundër administrimit të drejtësisë kur kanë lidhje me procedurat zyrtare dhe/ose me zyrtarë të DHSK-së.

■ DHSK-ja merret vetëm me përgjegjësi penale individuale - nuk do të gjykohe grupet ose organizatat.

- DHSK-ja lejon **pjesëmarrjen e viktimave** në procese gjyqësore.
- DHSK-ja dhe ZPS-ja financohen nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtete të treta kontribuese dhe janë të pavarura në përmbushjen e mandatit dhe kryerjen e punës së tyre.
- Gjuhët zyrtare të DHSK-së dhe ZPS-së janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja.
- DHSK-ja ka **Avokatin e Popullit**, i cili vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që **ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në**, ndër të tjera,
 - përmes procedurës së parashtrimit të ankesave prej personave
 - nëse ankesa ka të bëjë me ndërveprimin e tyre me DHSK-në ose ZPS-në
 - në rast të vonesave të paarsyeshme në një proces para DHSK-së
 - nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike të tjera
 - nëse ankesa paraqitet brenda gjashtë muajsh nga shkelja e pretenduar
- duke hyrë dhe inspektuar në çdo kohë dhe pa paralajmërim objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara, për vlerësimin e kushteve të paraburgimit.



Masat e KOVID-19

Në fillim të marsit 2020, pak pasi që Prokurori i Specializuar njoftoi Kryetaren që ka ndërmend të nisë procedim penal, me çka u caktua Gjykatësi i Procedurës Paraprake për rishikimin e aktakuzës, u përhap pandemia e KOVID-19. Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) menjëherë formuan grupin e punës për KOVID-19, me në krye Administratoren. Grupi i punës u mbledh çdo ditë për të vlerësuar pasojat e pandemisë në punën e institucionit, si dhe për të marrë masa në lidhje me të. Pandemia shkaktoi një situatë aq të jashtëzakonshme sa që masat ekzistuese për raste emergjente nuk ishin plotësisht të përshtatshme. Situata u rëndua edhe më tej nga fakti që pandemia u përhap mu në kohën kur duhej të kryhej punë kyçe në lidhje me fillimin e procedurave publike.

Në përgjigje të këtyre rrethanave, Zyra Administrative, Dhomat dhe ZPS-ja nisën riorganizimin drastik të punës së tyre të përditshme si gjykatë. Për shkak të përhapjes së shpejtë dhe rreziqeve të njohura dhe të panjohura të KOVID-19, DHSK-së iu desh të rishqyronte natyrën e detyrimeve të saj ndaj dëshmitarëve, të dyshuarve, të akuzuarve, si dhe ndaj punonjësve të vet. Pas një analize rrënjësore, udhëheqja e DHSK-së miratoi masa të gjithanshme për zbutjen e rrezikut, me qëllimin e përmbytjes së detyrimit të kujdesit të duhur, pa e ndërprerë punën e vet. Për shkak të dinamikës së pandemisë së KOVID-19, rregullisht bëhet ndryshimi dhe përshtatja e këtyre masave për të pasqyruar zgjidhjet më të mira nga praktika, gjithmonë me qëllimin e zvogëlimit të rrezikut në nivelin më të ulët të mundshëm.

Udhëzimet dhe masat parandaluese të miratuara nga udhëheqja e DHSK-së janë gjithmonë në përputhje me ato të shtetit pritës dhe synojnë të ruajnë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e të gjithë personave që janë në kontakt me DHSK-në dhe ZPS-në. Ato kanë të bëjnë me zyrat, hapësirat e përbashkëta, hapësirat publike, sallën e gjyqit,

objektin e paraburgimit dhe objektet jashtë shtetit pritës, ndër të cilat ato në Kosovë. Për këtë arsye, praktikat më të mira në lidhje me KOVID-19 janë përfshirë në një numër rregulloresh, ndër të tjera në Rregulloren e Paraburgimit, në procedurat lidhur me sigurinë dhe operacionet e transferimit dhe në Udhëzimin operativ për administrimin e mjediseve gjatë KOVID-19. Përveç rregulloreve, janë bërë dhe ndryshime dhe përshtatje fizike të mjediseve të gjykatës në shumë aspekte.

Falë këtyre masave, DHSK-ja vazhdoi aktivitetet gjyqësore dhe administrative të saj gjatë gjithë pandemisë së KOVID-19. Në ndërtesën e DHSK-së kanë qenë të pranishëm vetëm Kryetarja, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, Prokurori i Specializuar, Administratorja dhe një numër i vogël punonjësish, ndërsa të gjithë të tjerët kanë punuar nga distanca. Në të gjitha hapësirat publike ka qenë e detyrueshme mbajtja e maskave mbrojtëse dhe janë zbatuar edhe masa higjienike të tjera. Të gjithë punonjësit janë informuar rregullisht për rekomandimet e shtetit pritës në lidhje me udhëtimet. Për më tepër, masat e testimit dhe karantinës kanë qenë të detyrueshme dhe janë respektuar në pajtim me udhëzimet e shtetit pritës.

Pandemia e KOVID-19 ka pasur ndikim minimal në punën e gjykatës gjatë vitit 2020. Të gjitha procedurat publike u zhvilluan me shumicën e palëve të pranishme në sallën e gjyqit, me pjesëmarrjen e disa përfaqësuesve të ekipeve të mbrojtjes përmes videokonferencës, dhe me publikun të pranishëm në galerinë për publikun. Seancat u zhvilluan në tri gjuhët zyrtare të gjykatës dhe u transmetuan drejtpërdrejt në faqen e DHSK-së në Internet. Përkundër numrit të zmadhuar të përdoruesve nga distanca të softuerit të gjykatës, rrjeti ka funksionuar në mënyrë optimale për të gjithë përdoruesit.


Duke iu falënderuar në masë të madhe zgjuarsisë dhe përkushtimit të ekipit të Njësisë së Teknologjisë së Informacionit, teknikisht u mundësua puna nga distanca, si dhe takimet me përfaqësuesit e shoqërisë

civile në rajon në kuadër të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim. Këto zgjidhje teknike shpejt u përshtatën për të përmbushur nevojat shtesë. Brenda vetëm një fundjave në muajin mars, Njësia e Teknologjisë së Informacionit vuri në funksion platformën për punë nga distanca, në mënyrë që minimizoi ndërprerjet në punë dhe ruajti sigurinë. Ekipi i administrimit të informacionit ndërgjegjësoi punonjësit në të gjithë organizatën në lidhje me administrimin e aseteve të informacionit dhe organizoi takime informuese të shumta përmes videokonferencës.

Mirëqenia e personelit gjatë pandemisë së KOVID-19 ka qenë e rëndësishme parësore. Gjatë gjithë vitit 2020, u është ofruar mbështetje punonjësve që përballen me vështirësi që lidhen me punën nga shtëpia, me gjetjen e ekuilibrit midis punës dhe familjes, me kujdesin për të afërmit dhe me humbjen e të afërmeve. Kryetarja, Administratorja dhe Prokurori i Specializuar kanë dërguar rregullisht mesazhe javore për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së, duke i informuar për zhvillime të rëndësishme në punën e tyre, për t'ju dhënë atyre mbështetje dhe për të ruajtur nivelin e përkushtimit dhe motivimit.

Të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së kontribuan në mbajtjen lart të moralit. Për të ruajtur sadopak ndjenjën e normalitetit dhe kontaktit me kolegët, në pranverë, një grup punonjësish filluan me organizimin e programeve virtuale, në mënyrë që të gjithë punonjësit të mund të zbavitën dhe të mbajnë kontaktet shoqërore. Më i popullarizuar ishte programi FriDri, takim virtual në fund të javës së punës, me muzikë dhe aktivitete, i cili është organizuar pothuajse çdo të premte që nga fillimi i zbatimit të masave të KOVID-19. FriDri fitoi popullaritet në mesin e të gjithë punonjësve, duke përfshirë edhe drejtuesit, dhe herë pas herë këtij programi virtual iu bashkuan edhe gjykata të tjera ndërkombëtare në Hagë.


Në këtë mënyrë, ndërkohë që udhëheqja e DHSK-së është fuqimisht e vendosur të zbatojë masat e shëndetit dhe sigurisë për sa kohë që të jetë e nevojshme, ajo mbetet e përkushtuar ndaj komponentit njerëzor të situatës.







Dhomat



1 | Aktivitetet gjyqësore

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) punojnë si gjykatë nga korriku 2017, me hyrjen në fuqi të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (Rregullorja). Që nga ai moment, gjykatësit e DHSK-së janë të gatshëm të trajtojnë çfarëdo çështje juridike, përfshirë akuzat në aktakuzat që paraqet Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS).

PROCEDURAT PARA GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE

Viti i kaluar ka shënuar disa arritje sa u përket proceseve gjyqësore para DHSK-së. Me paraqitjen e aktakuzave në shkurt dhe prill, të cilat përmbajnë akuza për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte, Kryetarja caktoi gjykatësin Nikola Giju si Gjykatës të Procedurës Paraprake, për marrjen e vendimeve mbi konfirmimin ose rrëzimin e aktakuzave dhe për kryerjen e procedurave paraprake që mund të fillojnë si rezultat i kësaj. Gjykatësi i Procedurës Paraprake po ashtu u angazhua në një çështje lidhur me akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, në lidhje me të cilat Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzën në tetor. Si rezultat i kësaj, gjatë gjithë vitit 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dhe ekipi i tij i mbështetjes juridike kanë qenë të angazhuar aktivisht në procedura gjyqësore në tri çështje gjyqësore të ndryshme me gjithsej shtatë të akuzuar.

Gjatë vitit 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi 67 vendime dhe urdhra publikë në tri çështje gjyqësore të ndryshme, ku përfshihen vendimet për konfirmimin e aktakuzave në ato tri çështje, vendimet në lidhje me paraburgimin e të akuzuarve dhe vendimet që përcaktojnë modalitetet e pjesëmarrjes së viktimave. Vetëm nga fundi i shtatorit e deri në dhjetor, në sallën e gjyqit të DHSK-së u mbajtën katërmëdhjetë seanca, nga ato të paraqitjes së parë e deri në konferenca për ecurinë e çështjes. Në këto seanca ishin të pranishme të gjitha palët, qoftë fizikisht në sallën e gjyqit, ose përmes videokonferencës. Kjo rritje e jashtëzakonshme e aktiviteteve gjyqësore - një pjesë e madhe e të cilave janë të klasifikuara si konfidenciale dhe rrjedhimisht për to nuk mund të raportohet - u zhvillua pa pengesa, me gjithë masat në fuqi në lidhje me pandeminë.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake aktualisht është duke punuar aktivisht dhe po merr të gjitha masat për përgatitjen e shpejtë të të tri çështjeve për gjykim, në pajtim me rregullën 95(2) të Rregullores.

I.

Prokurori i Specializuar kundër Salih Mustafës

Më 12 qershor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e parë, në të cilën z. Salih Mustafa ngarkohet me katër akuza për krime lufte (ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme) të kryera në prill 1999. Në aktakuzë pretendohet se gjatë periudhës përkatëse, z. Mustafa ishte komandant i një njësie guerile brenda Zonës Operative të Llapit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Z. Mustafa u arrestua në Kosovë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së më 24 shtator, kurse seanca e paraqitjes së tij të parë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake u mbajt më 24 shtator. Më 28 tetor, z. Mustafa u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.



Paraqitja e parë e z. Salih Mustafa, 28 shtator 2020

II.

Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçi dhe të tjerëve

Më 26 tetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi, në të cilën ata ngarkohen me dhjetë akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

Gjatë periudhës që mbulon aktakuza, pretendohet se z. Thaçi ishte anëtar themelues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe shef i Drejtorisë Politike dhe Drejtorisë së Informimit të UÇK-së. Sipas aktakuzës, në fund të marsit 1999, z. Thaçi ishte Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK) dhe Kryekomandant i UÇK-së. Në Aktakuzë pretendohet se z. Veseli ishte anëtar themelues i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtar i

Drejtorisë Politike të UÇK-së, si dhe shef i shërbimeve të zbulimit të UÇK-së. Gjithashtu pretendohet se në fund të marsit 1999, pas krijimit të QPK-së, z. Veseli ishte shef i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe ministër i Shërbimit Informativ në QPK. Sipas Aktakuzës, z. Selimi ishte anëtar themelues i UÇK-së dhe shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së. Pretendohet se në korrik 1998, ai ishte Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe se në fillim të prillit 1999, pas formimit të QPK-së, u bë ministër i Rendit Publik. Në Aktakuzë pretendohet se z. Krasniqi ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar i UÇK-së.



Z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi gjatë paraqitjes së parë, nëntor 2020

Z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi u arrestuan dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë më 4 dhe 5 nëntor. Në seancat e paraqitjes së parë të tyre para Gjykatës të

Procedurës. Paraprake më 9, 10 dhe 11 nëntor, të akuzuarit u vetëdeklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

III.

Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt

Pas nxjerrjes së informacionit konfidencial, ndër të tjera të informacionit që mund të çojë në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur, më 24 shtator gjykatësi Nikola Giju, në cilësinë e Gjykatës të Vetëm, urdhëroi që z. Hysni Gucati, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së, dhe

z. Nasim Haradinaj, zëvendëskryetar i asaj organizate, të arrestohen për shkak të dyshimit të bazuar për orvatje të kryerjes së veprave penale të frikësimit të dëshmitarëve, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, dhe të transferohen në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë.



Z. Haradinaj gjatë paraqitjes së parë, dhjetor 2020



Z. Gucati gjatë paraqitjes së parë, tetor 2020

Seancat e paraqitjes së parë të z. Gucati dhe z. Haradinaj para Gjykatës të Vetëm u mbajtën, përkatësisht, më 1 tetor dhe më 29 shtator. Pas caktimit të gjykatës Giju si Gjykatës i Procedurës Paraprake më 29 shtator, Prokurori i Specializuar paraqiti aktakuzën më 30 tetor.

Z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen për katër vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë, për frikësim, për hakmarrje, dhe për shkelje të

fshehtësisë së procedurës. Më 18 dhjetor, z. Gucati dhe z. Haradinaj kishin paraqitjen e parë para Gjykatës të Procedurës Paraprake, gjatë së cilës z. Gucati u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës. Z. Haradinaj do të ketë mundësinë të vetëdeklarohet në lidhje me fajësinë ose pafajësinë për të gjitha akuzat më 8 janar 2021.

PROCEDURAT PARA DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT

Më 3 nëntor, z. Gucati apeloj dy vendime të gjykatësit Giju në lidhje me ligjshmërinë e fletarrestimit dhe refuzimin e kërkesës së tij për lirim me kusht. Më 4 nëntor u caktua paneli i Gjykatës së Apelit, i përbërë nga gjykatëse Mishelë Pikar (kryegjykatëse), gjykatës

Emilio Gati dhe gjykatës Kai Ambos. Më 9 dhjetor, Dhoma e Apelit hodhi poshtë tërësisht apelin e z. Gucati. Kjo ishte çështja e parë që u shqyrtua nga Gjykata e Apelit.

[...] lëshimi i fletarrestimit nga një gjykatës, në rastin konkret nga Gjykatësi i Vetëm, i ka ofruar z. Gucati më shumë mbrojtje, e jo më pak mbrojtje siç pretendohet prej tij. Paneli i Gjykatës së Apelit konstaton se përmes kërkimit të shqyrtimit dhe mbikëqyrjes së aktit të privimit të lirisë nga një organ i pavarur gjyqësor, ZPS-ja ka shkuar përtej asaj që kërkon Ligji dhe ka vepruar në përputhje me vetë qëllimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që është mbrojtja e individit nga arbitrariteti.

KSC-BC-2020-07/IA/001/F00005, Vendimi mbi apelin e Hysni Gucati për çështje të lidhura me arrestimin dhe mbajtjen e tij në paraburgimin, 9 dhjetor 2020, para. 39.

PROCEDURAT PARA DHOMËS SË SPECIALIZUAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE

Dhoma e Specializuar e Gjykatës e Kushtetuese (DHSGJK) shqyrtoi një numër referimesh gjatë vitit 2020.

Më 13 janar, paneli i DHSGJK-së e shpalli të papranueshme kërkesën referuese të një personi që ishte thirrur nga ZPS-ja dhe i cili kundërshtoi ligjshmërinë e procedurës së marrjes në pyetje.

Më 12 qershor, paneli i DHSGJK-së lëshoi versionin e redaktuar publik të vendimit të vet të 20 prillit. Në atë vendim, paneli i DHSGJK-së konstatoi se parashtruesi – entitet publik në Kosovë - nuk kishte të drejtë ligjore për të kundërshtuar vendimin e Gjykatësit të Vetëm dhe rrjedhimisht hodhi poshtë kërkesën referuese të parashtruesit.

Dhoma rithekson se, për sa u takon çështjeve penale, qëllimi kryesor i nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës është që një të akuzuari t'i garantohet në tërësi gjykim i drejtë nga një gjykatë kompetente për të vendosur në lidhje me një akuzë penale. Në mënyrë të ngjashme, garancitë minimale në bazë të nenit 30(1), (3) të Kushtetutës dhe nenit 6(3)(a),(b) të Konventës nuk janë qëllime në vetvete: qëllimi i qenësishëm i tyre është që të kontribuojnë në garantimin e drejtësisë së procedurave penale në tërësi.

KSC-CC-2019-07/F00013, Vendim mbi kërkesën referuese të Driton Lajçit në lidhje me procedurën e marrjes në pyetje nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, 13 janar 2020, para. 21

Parashtruesi është entitet publik që ushtron kompetencë qeveritare. Për këtë arsye, ai është një 'organizatë qeveritare' dhe si e tillë nuk ka të drejtë të pretendojë të drejtat në bazë të Konventës të përfshira në nenin 22(2) të Kushtetutës.

KSC-CC-2020-08/F00020/RED, Version i redaktuar publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në vijim të vendimit të Gjykatësit të Vetëm, 12 qershor 2020, para. 61.

Më 26 nëntor, paneli i DHSGJK-së shqiptoi aktgjykimin mbi referimin e Kryetares së Kuvendit të Kosovës të amendamenteve të propozuara të Kushtetutës. Paneli i DHSGJK-së arriti në përfundimin se amendamentet kushtetuese në lidhje me mandatin e DHSK-së dhe ZPS-së, të propozuara nga Presidenti i atëhershëm Hashim Thaçi, pakësonin të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kapitulli II i Kushtetutës.

Nga veçoritë e Dhomave të Specializuara dhe ZPS-së të parapara në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 dhe duke mbajtur parasysh "administrimin e duhur të drejtësisë", del qartë se synimi i këtij Shkëmbimi të Letrave ishte që Dhomat e Specializuara dhe ZPS-ja të funksiononin në mënyrë autonome. Një rrjedhim tjetër është që funksionimi në mënyrë autonome sigurohet kryesisht përmes bartjes së disa kompetencave sovrane për aq kohë sa zgjatë mandati, çka sjellë edhe krijimin e kornizës së tyre ligjore.

KSC-CC-2020-11/F00015, Aktgjykim mbi Referimin e amendamenteve të propozuara të Kushtetutës së Kosovës, 26 nëntor 2020, para. 63.

2 | Aktivitetet e Kryetares dhe të gjykatësve

Gjykatësit e DHSK-së emërohen në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri) dhe kryejnë funksionet gjyqësore të tyre sipas nevojës dhe vetëm me kërkesë të Kryetares. Në përputhje me nenin 26 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji), gjykatësit nuk marrin shpërblim e as përfitime të tjera për shkak se janë në Regjistër, por vetëm kur caktohen nga Kryetarja për të kryer funksionet zyrtare të tyre. Gjykatësit e caktuar, për aq sa është e mundur, kryejnë funksionet gjyqësore të tyre nga distanca.

PLENARJA VJETORE

Pandemia nuk i pengoi gjykatësit e DHSK-së që të kryenin detyrat e tyre gjatë vitit 2020. Në përputhje me Ligjin, gjykatësit mbajtën plenaren vjetore më 29 dhe 30 prill, përmes videokonferencës. Në plenare, Gjykatës Çarls Smith III u zgjodh nënkryetar. Gjithashtu, gjykatësit miratuan 30 ndryshime të disa rregullave të Rregullores, të cilat janë testuar gjatë punës së përditshme të Dhomave, ZPS-së dhe Zyrës Administrative. Ndryshimet sqarojnë disa dispozita dhe në përgjithësi synojnë të sigurojnë procedura më efikase. Gjykatësit gjithashtu u informuan nga drejtuesit për çështje në lidhje me DHSK-në dhe ZPS-në.

Në pajtim me Ligjin, ndryshimet e miratuara të Rregullores u shqyrtuan nga DHSGJK-ja për nga përputhshmëria e tyre me Kapitullin II të Kushtetutës. Më 26 maj, DHSGJK-ja shqiptoi aktvendimin e vet, ku konstatoi se që të 30 ndryshimet e Rregullores, të miratuara nga gjykatësit gjatë plenares, ishin në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës, me çka ato hynë në fuqi.

Kryetare Ekaterina Trendafilova është e pranishme në selinë e DHSK-së dhe është e vetmja gjykatëse me orar të plotë pune për shkak të përgjegjësive për administrimin gjyqësor të DHSK-së dhe një numri funksionesh të tjera kyçe që i ngarkohen me Ligj dhe Rregullore.

Dhoma rikujton parimin e përcaktuar në jurisprudencën e saj se, për shqyrtimin e Rregullores, Dhoma duhet të niset prej nenit 19(2) të Ligjit sipas të, cilit Rregullorja "pasqyron standardet më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut [...]". Në këtë kontekst, Dhoma pranon se gjykatësit e mbledhur në Plenare kishin për qëllim përmbushjen e standardeve më të larta të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

KSC-CC-PR-2020-09, Aktvendim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, 22 maj 2020, para. 14.

EMËRIMI I GJASHTË GJYKATËSVE TË RINJ NË REGJISTRIN E GJYKATËSVE NDËRKOMBËTARË

Në shtator, në bazë të rekomandimeve të Komisionit Përzgjedhës të pavarur, Autoriteti Emërues, ambasador Lars-Gunar Uigemark, emëroi gjashtë gjykatës të rinj në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë (Regjistri), në pajtim me nenin 28(4) të Ligjit. Gjykatësit, z. Zhilber Biti (Francë), z. Daniel Fransen (Belgjikë), z. Fergal M. Gejnor (Irlandë), znj. Romina Inkuti (Itali), znj. Nina H. B. Jorgensen (Norvegji) dhe z. Rumen H. Nenkov (Bullgari) u bashkohen 17 gjykatësve të tjerë në Regjistër.

Gjithashtu, Autoriteti Emërues emëroi gjykatësit Antonio Balsamo dhe Rumen Nenkov si gjykatës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, dhe gjykatësen Romina Inkuti si gjykatëse rezervë të asaj Dhome. Me kërkesë të tij, gjykatës Roland Dekers nuk është më gjykatës i Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, por mbetet në Regjistër, që i mundëson të caktohet në cilëndo Dhomë tjetër, me përjashtim të asaj të Gjykatës Kushtetuese.

Krahas gjykatësit Nenkov, i cili bëri betimin më herët më 27 shtator për të marrë detyrën në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, gjykatësit e rinj bënë betimin gjatë një ceremonie në Internet më 2 tetor, në praninë e gjykatësve të DHSK-së, Prokurorit të Specializuar, Zëvendësprokurorit të Specializuar dhe Administratores, e cila drejtoi ceremoninë e betimit.



Ceremonia e betimit, 27 shtator 2020

RIEMËRIMI I KRYETARES EKATERINA TRENDAFILOVA

Më 30 tetor, Autoriteti Emërues riemëroi gjykatëse Ekaterina Trendafilovën si Kryetare të DHSK-së edhe për një mandat katërvjeçar, duke filluar nga data 15 dhjetor, në pajtim me nenin 30(4) të Ligjit.

Kryetare Trendafilova shprehu mirënjohjen për "besimin që i është dhënë [asaj] për të vijuar t'u shërbejë Dhomave të Specializuara të Kosovës të cilat sapo kanë hyrë në një fazë të re dhe përgatiten për fillimin e procedurave penale".

Kryetarja Ekaterina, DHSK, tetor 2020.

Gjykatësit në Regjistrin e Gjykatësve Ndërkombëtarë



Gjakatëse Ekaterina Trendafilova
Kryetare
(Bullgari)



Gjakatës Çarls L. Smith III
Nënkryetar
(SHBA)



Gjakatës Vidar Stensland
Gjakatës Kushtetues
(Norvegji)



Gjakatës Antonio Balsamo
Gjakatës Kushtetues
(Itali)



Gjakatës Rumen Nenkov
Gjakatës Kushtetues
(Bullgari)



Gjakatëse Romina Inkuți
Gjakatëse Kushtetuese Rezervë
(Itali)



Gjakatëse Kristinë van den
Vajngart
(Belgjikë)



Gjakatëse Mishelë Pikar
(Francë)



Gjakatës Tomas Laker
(Gjermani)



Gjakatës Emilio Gati
(Itali)



Gjakatës Roland Dekers
(Holandë)



Gjakatës Mihael Bolander
(Gjermani)



Gjakatës Kai Ambos
(Gjermani)



Gjakatës Kenet Roberts
(Kanada)



Gjakatëse MapiFeld-Folia
(Holandë)



Gjakatës Kristof Barte
(Gjermani)



Gjakatës Vladimir Mikula
(Republika Çeke)



Gjakatës Gënel Metro
(Zvicër)



Gjakatës Nikola Giju
(Francë)



Gjakatës Zhibler Biti
(Francë)



Gjakatës Daniel Fransen
(Belgjikë)



Gjakatës Fergal Gejnor
(Irlandë)



Gjakatëse Nina Jorgensen
(Norvegji)

3 | Aktivitetet e jashtme të Kryetares

Gjatë vitit 2020, Kryetare Trendafilova vazhdoi të sigurojë informimin e rregullt të publikut dhe palëve të interesuara në lidhje me aktivitetet e DHSK-së. Për këtë qëllim, Kryetarja u takua me përfaqësues të institucioneve të BE-së, të shteteve anëtare të BE-së, të shtetit pritës dhe të shteteve të treta kontribuese.

Më 5 qershor, Kryetarja bëri një prezantim para grupit të punës për të drejtën penale ndërkombëtare nga Gjermania, ku informoi për strukturën dhe mandatin e DHSK-së, si dhe për karakteristikat e veçanta të gjykatës.



Më 25 shtator, përmes videokonferencës, Kryetarja iu drejtua Komitetit të këshilltarëve ligjorë për të drejtën ndërkombëtare publike të Këshillit të Evropës, ku foli për mandatin, juridiksionin dhe punën e DHSK-së, shpjegoi strukturat e jashtme dhe të brendshme drejtuese të DHSK-së, si dhe specifikat e kornizës ligjore të DHSK-së.

Gjithashtu, më 29 shtator, Kryetarja pati takim të drejtpërdrejtë me Komitetin politik dhe të sigurisë të BE-së në Bruksel, ku i informoi përfaqësuesit e shteteve anëtare për aktivitetet gjyqësore të DHSK-së, iu përgjigj pyetjeve të tyre, dhe diskutoi sfidat aktuale me të cilat përballlet DHSK-ja.


Për të forcuar më tej marrëdhëniet e DHSK-së me aktorë të tjerë të jashtëm dhe me shoqërinë civile, Kryetarja zhvilloi takime (kryesisht përmes videokonferencës) me anëtarë të komuniteteve të diplomatëve, juristëve, gazetarëve dhe akademikëve. Kryetarja gjithashtu dha intervista, në të cilat shpjegoi mandatin dhe punën e DHSK-së.

Drejtësia – qoftë vendore apo ndërkombëtare – është një nga aspektet më mahnitëse dhe më shpërblyese të shoqërisë sonë, ku njeriu ballafaqohet me sfida nga më të ndryshmet – nga sasia e madhe e punës, pushimi i pamjaftueshëm, rraskapitja, e deri tek frustrimi për shkak të mungesës së rezultateve apo të realizimit të ngadaltë të tyre. Megjithatë, kënaqësia që ofrojnë realizimi i drejtësisë për viktimat e krimeve dhe nxjerrja para përgjegjësisë e atyre që janë përgjegjës për ato krime, e shpërblejnë të gjithë mundin.

Kryetare Trendafilova, Intervistë për Buletin e Bibliotekës së Pallatit të Paqes, nëntor 2020



Marrëdhëniet me jashtë



Marrëdhëniet me jashtë


Drejtuesit kryen aktivitete të ndryshme dypalëshe lidhur me bashkëpunimin me Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (ZPS).

Në shkurt, drejtuesit patën takim lamtumire me komandantin e operacioneve civile të Bashkimit Evropian, gjeneral Vinçenco Kopola, në përfundim të mandatit të tij, dhe e falënderuan atë për përkrahjen e tij për DHSK-në dhe ZPS-në. Më 9 korrik, përmes videokonferencës, tre drejtuesit informuan shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese për zhvillimet më të fundit në DHSK dhe ZPS, ndër të tjera për nisjen e procedimeve nga Prokurori i Specializuar. Shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese ritheksuan mbështetjen e tyre të fuqishme për punën e dy institucioneve, për çka drejtuesit shprehën mirënjohjen e tyre.


Drejtuesit u takuan gjithashtu me anëtarin e Parlamentit Evropian dhe raportuesen e Parlamentit Evropian për Kosovën, zonjën Viola von Kramon-Taubadel, në mjediset e gjykatës, dhe e informuan atë për aktivitetet më të fundit të DHSK-së dhe ZPS-së.

Gjatë vitit 2020, drejtuesit u takuan disa herë me komandantin e operacioneve civile të BE-së. Më 10 nëntor, drejtuesit u takuan me komandantin e ri, gjeneralmajor Francisko Esteban Perez, i cili vizitoi DHSK-në dhe ZPS-në në Hagë dhe ishte i pranishëm në një seancë gjyqësore në galerinë për publikun.

Në kuadër të takimeve informuese vjetore, Kryetarja, Prokurori i Specializuar dhe Administratorja informuan përmes videokonferencës përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së me seli në Prishtinë më 7 dhjetor, dhe përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së dhe të shteteve të treta kontribuese me seli në Hagë më 8 dhjetor, për punën e DHSK-së dhe ZPS-së.



Zyra Administrative



Zyra Administrative

Nën drejtimin dhe administrimin strategjik të Administratores, Zyra Administrative është përgjegjëse për administrimin dhe shërbimet për Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK), si edhe për kryerjen e të gjitha funksioneve të tjera të nevojshme mbështetëse. Administratorja është e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj, dhe këshillohet me Kryetaren dhe Prokurorin e Specializuar për çështje institucionale.

Në kuadër të mbështetjes administrative që ofron Zyra Administrative për Dhomat dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar përfshihen buxheti, financimi, prokurimi, teknologjia e informacionit, administrimi i objekteve, burimet njerëzore dhe siguria. Në kuadër të mbështetjes gjyqësore përfshihen mbrojtja dhe mbështetja e dëshmitarëve, administrimi i Listës së Mbrojtësve, administrimi i sistemit të ndihmës juridike dhe të pjesëmarrjes së viktimave, shërbimet e përkthimit me shkrim dhe me gojë, administrimi i gjykatës dhe administrimi i objektit të paraburgimit të DHSK-së.

Dr. Fidelma Donlon u riemërua Administratore në prill 2020. Ajo është nënshkruesja në emër të DHSK-së e marrëveshjes për subvencionim me Bashkimin Evropian, që është burimi kryesor i financimit të gjykatës. Në emër të DHSK-së, ajo gjithashtu ka nënshkruar marrëveshje për subvencionim me qeveritë e Norvegjisë dhe Zvicrës, të cilat financojnë mirëmbajtjen e mjediseve të DHSK-së dhe ZPS-së si dhe aktivitetet e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së në Kosovë.

Në vitin 2020 u arritën disa objektiva kyçe. Ekipi ligjor i Kabinetit të Administratores (KA) u përqendrua në hartimin e paketës së dokumenteve në lidhje me Rregulloren e Paraburgimit dhe të Rregullores së Ndihmës Juridike, të cilat u miratuan nga Administratorja, pas këshillimeve me Kryetaren. Rregullorja e Ndihmës Juridike pasqyron praktikat më të mira të standardeve të ndihmës juridike, duke




Administratore Fidelma Donlon

garantuar respektimin e parimeve të gjykimit të drejtë dhe duke mundur miradministrim financiar të fondeve të skemës së ndihmës juridike. Rregullorja e Paraburgimit plotëson dhe madje tejkalon standardet më të larta ndërkombëtare. Gjithashtu, Administratorja mbikëqyri transferimin e sigurt të shtatë personave në objektin e paraburgimit.

Administratorja është gjithashtu përgjegjëse për marrëdhëniet me shtetin pritës dhe marrëdhëniet diplomatike, ku përfshihet edhe negocimi i marrëveshjeve për bashkëpunim me shtetet. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2020, Zyra Administrative u përqendrua në dy objektiva kryesore: e para, nxitja e vazhdueshme e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese që të emërojnë kandidatë për vende pune në DHSK dhe ZPS dhe, e dyta, kërkesat për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve. I rëndësishëm kyçe ishte edhe koordinimi me politikën e shtetit pritës në lidhje me KOVID-19. Ky bashkëpunim i mundësoi DHSK-së zbatimin e planit të vazhdueshmërisë së punës, çka e bëri të mundur zhvillimin e pandërprerë të veprimtarive, duke i marrë njëkohësisht të gjitha masat në lidhje me mirëqenien e punonjësve dhe të personave të tjerë që kërkohet të jenë të pranishëm në DHSK.

Në nëntor, pasi që Shërbimi i Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ) miratoi Strategjinë kundër mashtrimeve dhe plan-veprimin konkret për Misionet e BE-së për Politikë të Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes, Administratorja nxori Strategjinë e DHSK-së kundër mashtrimeve, e cila riafirmoi përkushtimin e fuqishëm të DHSK-së për hetimin dhe parandalimin e mashtrimeve duke iu përmbajtur standardeve të rrepta etike, duke kultivuar kulturën e mosdëshkimit të raportuesve të parregullsisë, dhe duke përcaktuar qartë kompetencat ekzekutive dhe ndarjen e përgjegjësisë. Strategjia kundër mashtrimeve përcakton kriteret konkrete të raportimit të rasteve të mundshme të mashtrimit dhe të parregullsisë të tjera Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimeve.





1 | Kabineti i Administratores

Kabineti i Administratores (KA) mbështet Administratoren në punën e saj. Ekipi ligjor i Kabinetit të Administratores jep rekomandime për një sërë çështjesh ligjore të brendshme dhe të jashtme, ku përfshihen interpretimi dhe zbatimi i instrumenteve të ndryshme ligjore, përpunimi i kornizës ligjore të brendshme të Zyrës Administrative, përshtatja e rregulloreve të brendshme ndaj rrethanave të pandemisë, bashkëpunimi me organizata dhe entitete të tjera, çështjet në lidhje me privilegjet dhe imunitetet, dhe bashkëpunimi me shtetet. Ekipi ligjor i Kabinetit të Administratores gjithashtu përgatit parashtrime ligjore lidhur me një spektër të gjerë çështjesh.

Ndër detyra të tjera që koordinon Kabineti i Administratores përfshihen organizimi i takimeve të brendshme të kuadrit udhëheqës, marrëdhëniet diplomatike, raportimi në BE dhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si dhe seksioni protokollar për DHSK-në dhe ZPS-në. Në vitin 2020, seksioni protokollar i Kabinetit të Administratores luajti një rol të rëndësishëm në lidhje me seancat publike, përmes ofrimit të mbështetjes anëtarëve të familjes të pranishëm në seanca gjyqësore, si dhe

mundësimin të vizitave përmes videolidhjes në objektin e paraburgimit në vend të vizitave personale, për të garantuar sigurinë e të paraburgosurve dhe të personave të tjerë në objektin e paraburgimit gjatë pandemisë së KOVID-19.

Njësia e Administrimit të Informacionit në kuadër të Kabinetit të Administratores ofron këshilla për administrimin e sigurt të informacionit, dokumentacionit dhe arkivave të DHSK-së, si dhe për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm.

Gjatë 2020, Njësia e Administrimit të Informacionit organizoi trajnimin e punonjësve në lidhje me Direktivën administrative për administrimin e aseteve të informacionit dhe Udhëzimin operativ për mbrojtjen e aseteve të informacionit, ku ky i fundit përmban udhëzime për trajtimin e informacionit të klasifikuar. Kjo njësi gjithashtu administroi kërkesat për mbrojtjen e të dhënave dhe vazhdoi me ofrimin e shërbimeve bibliotekare dhe të mbështetjes në punën hulumtuese të punonjësve dhe zyrtarëve të emëruar, duke mundësuar gjithashtu edhe qasje në burimet e bibliotekës nga distanca.



2 | Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun

Njësia për Informim dhe Komunikim me Publikun (NJKP) është përgjegjëse për komunikimin me gazetarë dhe publikun, për të siguruar informimin e saktë të një audience sa më të gjerë në lidhje me gjykatën dhe aktivitetet e saj. Kjo njësi administron një program solid për komunikim dhe ndërgjegjësim, si dhe drejton programin për vizitorët e DHSK-së dhe organizon vizitat në gjykatë gjatë seancave publike.

Me publikimin e aktakuzave dhe arrestimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të parë në vitin 2020, puna e DHSK-së hyri në një fazë të re, në të cilën aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit u intensifikuan.

Në përputhje me masat për zbutjen e rrezikut nga KOVID-19, Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim zhvilloi qasje novatore që i mundësuan DHSK-së të vazhdojë dialogun me popullatën e Kosovës dhe rajonin më të gjerë përmes Internetit, si dhe të shpërndajë informacionin për gjykatën dhe punën e saj përmes televizionit dhe mjeteve të tjera të informimit publik. Të gjitha seancat publike që u zhvilluan gjatë vitit 2020 u transmetuan në gjuhët shqipe, anglishte dhe serbishte përmes faqes së DHSK-së në Internet, duke i mundësuar kështu gjithkujt që të përcjellë procedurat në Internet në cilëndo nga tri gjuhët zyrtare të gjykatës.



Kryetarja dhe Administratorja duke bërë prezantim në takimin e RRIJG-së, tetor 2020

2.1 | Marrëdhëniet me mediat

Me paraqitjen e aktakuzës së parë nga Prokurori i Specializuar në shkurt, interesimi i mediave në Kosovë dhe në skenën ndërkombëtare për punën e DHSK-së u rrit në mënyrë dramatike gjatë vitit 2020. Si përgjigje, drejtuesit i intensifikuan kontaktet e tyre të drejtpërdrejta me mediat. Për shembull, në nëntor, Kryetare Ekaterina Trendafilova botoi në mediat kosovare një artikull për të drejtat e të akuzuarve dhe të dyshuarve që paraqiten para DHSK-së dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe viktimave, si dhe një intervistë në mediat serbe në dhjetor.

Në vitin 2020, zëdhënësit e DHSK-së iu përgjigjën qindra pyetjeve të mediave, dhanë një numër videointervistash dhe zhvilluan përmes Internetit disa tryeza të rrumbullakëta me gazetarë nga Kosova dhe rajoni, për t'u dhënë mediave informacion më të hollësishëm në mënyrë që të sigurohet raportimi objektiv për proceset gjyqësore.

Në ndërtesën e DHSK-së ndodhet qendra për mediat ku gazetarët mund të punojnë e njëkohësisht të përcjellin e incizojnë procedurat nga tryezat e tyre të punës, si dhe salla e konferencave për shtyp. Në përgjigje të kufizimeve në lidhje me udhëtimet në rrethana të pandemisë së KOVID-19, dhoma e konferencave për shtyp është pajisur plotësisht për të mundësuar pjesëmarrjen fizike dhe nga distanca të gazetarëve nga Kosova apo nga cilido vend tjetër në botë, në konferencat për shtyp, me përkthim simultan. Ndryshimi dhe përshtatja e këtyre dy hapësirave u bë në kuadër të përgjigjes së DHSK-së ndaj rrethanave të shkaktuara nga KOVID-19. Të dy hapësirat u përdorën nga gazetarët gjatë seancave të shumta në vitin 2020.



2.2 | Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim

Vendosja dhe kultivimi i dialogut me njerëzit në Kosovë në lidhje me mandatin dhe punën e DHSK-së ka qenë shtylla e strategjisë së komunikimit të DHSK-së që nga fillimi.

Në vitin 2020, qeveria zvicerane vazhdoi mbështetjen me një subvencion zemërgjerë dyvjeçar për fazën e dytë të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, e cila parashikon kultivimin e një dialogu të rregullt përmes aktiviteteve për komunikim dhe ndërgjegjësim, si dhe njoftimit më të mirë të publikut më të gjerë në Kosovë me punën e DHSK-së përmes intensifikimit të bashkëpunimit me mediat kryesore. Qeveria zvicerane i ka mbështetur aktivitetet komunikuese dhe ndërgjegjësuere të DHSK-së që nga viti 2018.

Duke mbajtur parasysh kufizimet në lidhje me udhëtimet dhe tubimet publike për shkak të pandemisë, në prill 2020, ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së, në bashkëpunim me OJQ-të partnere, filloi t'i mbajë aktivitetet e veta ndërvepruese me audiencat në Kosovë dhe Serbi përmes Internetit. U organizuan disa tryeza të rrumbullakëta virtuale me gazetarë për

informimin me kohë të tyre për procedurat publike para DHSK-së dhe dhënien e intervistave në lidhje me to mediave të interesuara.

Në vitin 2020, DHSK-ja vazhdoi me marrjen e komenteve dhe rekomandimeve të vyera në lidhje me aktivitetet informuese, komunikuese dhe ndërgjegjësuere të saja nga Rrjeti i informimit të gjykatës - një forum i krijuar nga DHSK-ja në vitin 2018, i përbërë nga 15 OJQ nga Kosova dhe Serbia. Në fillim të vitit 2020, Rrjeti i informimit të gjykatës mbajti një seminar këshillimor në Prishtinë, në të cilin përfaqësuesit e OJQ-ve paraqitën mendimet e tyre për materialet informative konkrete, ndër të tjera për videoklipet e para të përgatitura nga gjykata mbi mandatin e gjykatës dhe procesin e pjesëmarrjes së viktimave. Gjatë vitit 2020, ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së zhvilloi përmes Internetit edhe disa takime këshillimore të tjera me partnerët e vet. Pas fillimit të procedurave publike, Kryetarja dhe Administratorja iu drejtuan Rrjetit të informimit të gjykatës në një diskutim ndërveprues të organizuar në Internet, duke folur për fillimin e procedurave dhe ndikimin e kësaj mbi komunikimin në të ardhmen.

The slide features the Kosovo Specialist Chambers logo and the title "What crimes can be tried by the KSC?". A timeline at the top shows the years 1998, 1999, and 2000. Below the timeline, a flowchart is divided into two main sections: "Where?" and "Who?". The "Where?" section is a blue box containing the text "crimes 'commenced or committed' in Kosovo". The "Who?" section is a larger blue box containing two sub-sections: "By Kosovo/FRY citizens" and "Against Kosovo/FRY citizens". Arrows indicate a flow from the timeline to the "Where?" box, and from the "Where?" box to the "Who?" box. A plus sign is placed between the "Where?" and "Who?" boxes. On the right side of the slide, there are four small video windows showing participants in a virtual meeting, with names like "KSC Outreach", "KSC Outreach", "Elinor Schmitt", and "Youth Initiative" visible.

Takim i organizuar nga Programi për komunikim dhe ndërgjegjësim me Iniciativën e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR), prill 2020

Veprimtaritë kryesore të Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim

- Për shkak të rrethanave të shkaktuara nga pandemia e KOVID-19, aktivitetet ndërvepruese për komunikim dhe ndërgjegjësim me audiencat në Kosovë dhe Serbi u zhvendosën në Internet. 91% e pjesëmarrësve në aktivitetet e organizuara gjatë vitit 2020 deklaruan se do të dëshironin të merrnin pjesë në më shumë aktivitete komunikuese dhe ndërgjegjësuese të organizuara nga DHSK-ja në të ardhmen.
- Në vitin 2020, ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim zhvilloi 20 aktivitete për të rinjtë, përfaqësuesit e shoqërisë civile, studentët e drejtësisë, gazetarët dhe përfaqësuesit e pakicave në të gjithë Kosovën. Në aktivitetet e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim morën pjesë 450 pjesëmarrës nga Kosova, të pranishëm fizikisht ose nga distanca.
- DHSK-ja përgatiti disa videoklipe informuese për pjesëmarrjen e viktimave, Avokatin e Popullit dhe masat mbrojtëse për dëshmitarët. Videoklipet janë transmetuar në kohët e shikueshmërisë më të lartë në disa kanale televizive në Kosovë dhe Serbi, në gjuhën shqipe dhe serbishte.



Aktivitet i Programit për Komunikim dhe Ndërgjegjësim në Universitetin Amerikan, Kosovë, shkurt 2020

2.3 | Vizitat në DHSK

Në fillim të vitit 2020, në kuadër të programit për vizitorët, DHSK-ja mirëpriti disa grupe studentësh dhe juristësh në mjediset e saj për vizita të organizuara dhe prezantime për institucionin. Duke filluar nga marsi, për shkak të pandemisë së KOVID-19, vizitat në ndërtesë nuk ishin më të mundshme dhe në vend të tyre u organizuan vizita virtuale për studentë dhe grupe të tjera. Në tetor, DHSK-ja gjithashtu mori pjesë në Ditën e Vizitave të Institucioneve Ndërkombëtare në Hagë, që këtë vit u organizua përmes Internetit. Në faqen e Internetit të Ditës së Vizitave u publikua informacion në lidhje me DHSK-në, si edhe një vizitë virtuale e sallës së gjyqit dhe një seminar në Internet i hapur për publikun.

Megjithëse vizitat e grupeve të organizuara u ndërprejnë përkohësisht në pranverë të vitit 2020, vizitorët individualë kishin mundësinë e regjistrimit paraprak për përcjelljen e seancave gjyqësore publike nga galeria për publikun, e cila është ngjitur me sallën e gjyqit, ku numri i ulëseve të disponueshme ishte i kufizuar. Në kuadër të masave për zbutjen e rrezikut të përhapjes së KOVID-19 janë bërë ndryshime dhe përshtatje të galerisë për publikun, në përputhje me masën e mbajtjes së distancës dhe masat e tjera të shëndetit publik.



Vizitë e grupit nga Universiteti FEDI i Bordosë, shkurt 2020



Vizitë e grupit nga Akademia Ndërkombëtare në Hagë, janar 2020

2.4 | Informacioni publik për DHSK-në

Në kuadër të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, gjatë vitit 2020, DHSK-ja intensifikoi punën e saj në përgatitjen dhe transmetimin e videoklipeve informuese në tri gjuhët zyrtare të gjykatës. Videoklipet e shkurtra informative për tema të ndryshme - duke filluar nga mandati i DHSK-së e deri tek mbrojtja e dëshmitarëve dhe pjesëmarrja e viktimave - u transmetuan 246 herë në 12 kanale televizive në Kosovë në gjuhën shqipe dhe serbishte, 45 herë në dy kanale televizive në Serbi, dhe gjenden gjithashtu edhe në faqen e Internetit dhe në kanalën YouTube të DHSK-së.

Pas aktakuzave të para dhe arrestimeve, faqja e Internetit e DHSK-së u përditësua me një numër rubrikash dhe përmbajtjesh të reja në lidhje me procedimet.

Rubrika e përditësimeve në kohë reale dhe kalendari i gjykatës në ballinën e DHSK-së në Internet përmbajnë informacion më të fundit për seancat e planifikuara gjyqësore, kurse faqet e reja me të dhënat e çështjeve gjyqësore ofrojnë informacion shtesë për procedurat në vazhdim. Në shtator u aktivizua funksioni i transmetimit, i cili u mundëson njerëzve të shikojnë seancat gjyqësore të mbajtura deri më tani në të tri gjuhët zyrtare, dhe ato janë parë mbi 85.000 herë.

Gjatë vitit 2020, faqen e DHSK-së në Internet e shikuan më shumë se 113.000 njerëz, kurse vetë faqja u shikua gati 800.000 herë, nga të cilat 80% ishin shikues për herë të parë ndërsa 20% të përparshëm. Vetëm në shtator, faqja e DHSK-së në Internet u shikua më shumë se 117.000 herë.



Veprimtari kryesore komunikimi

- Me fillimin e procedurave në tri çështje gjyqësore, video-transmetimi i cilësisë së lartë u mundësoi njerëzve në mbarë botën përcjelljen e 14 seancave publike në Internet në të tri gjuhët e gjykatës - shqipe, serbishte dhe anglishte. Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2020, faqja e transmetimit që mundëson ndjekjen e seancave gjyqësore publike të DHSK-së u shikua më shumë se 85.000 herë.
- Në faqen e DHSK-së në Internetit u shtuan përmbajtje të reja të rëndësishme, ndër të cilat rubrika e përditësimeve në kohë reale, kalendari i gjykatës dhe faqet me të dhënat e çështjeve gjyqësore, si edhe përmbajtje të reja në lidhje me pjesëmarrjen e viktimave, ndihmën juridike dhe paraburgimin.
- Numri i shikuesve të faqes së DHSK-së në Internet u rrit me më shumë se 150%, me gati 800.000 vizita të faqes në vitin 2020. Rritja më e madhe u shënua kur filluan proceset publike në shtator: atë muaj, faqen e shikuan 20.000 persona, që është dy herë më shumë se mesatarja mujore e përparshme.
- Drejtuesit e DHSK-së u angazhuan drejtpërdrejt me mediat, si për shembull botimi i artikullit nga Kryetarja në muajin nëntor.

3 | Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës

Avokati i Popullit i DHSK-së është i pavarur në monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në. Ngritja e Zyrës së Avokatit të Popullit brenda strukturës së DHSK-së dhe ZPS-së është diçka e veçantë, në kuptimin që ofron një mekanizëm më shumë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave që ndërveprojnë me këto institucione.

Avokati i Popullit i DHSK-së është Pjetro Spera, gjykatës italian, i cili u emërua në këtë post në maj të vitit 2018. Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit përshkruhen hollësisht në amendamentin nr. 24 të Kushtetutës së Kosovës, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në Rregulloren e Procedurës dhe të Provave dhe në Rregulloren e Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.



Avokati i Popullit Pjetro Spera

Në vitin 2020, Avokatit të Popullit iu paraqitën gjashtë ankesa. Ai shqyrtoi dhe u dha përgjigje pesë prej tyre. Të gjitha çështjet e zgjidhura u gjykuan të papranueshme me arsyetimin se ankuesit nuk kishin paraqitur argumente të mjaftueshme, ose nuk kishin vërtetuar se ankesat kishin të bënin me DHSK-në ose ZPS-në. Të gjithë ankuesve iu komunikua rezultati i ankesave dhe vendimet përkatëse me arsyetimin e plotë.

Në kuadër të funksionit të vet monitorues, gjatë gjithë vitit Avokati i Popullit kishte shkëmbime konstruktive me DHSK-në dhe ZPS-në me qëllim garantimin e respektimit të përpiktë të standardeve më të larta të të drejtave të njeriut.

Në shkurt të vitit 2020, Avokati i Popullit vizitoi objektin e paraburgimit të DHSK-së, ku shefi i Njësisë së Paraburgimit të DHSK-së e informoi lidhur me objektin dhe mënyrën e funksionimit të tij.

Në tetor të vitit 2020, pas referimit të amendamentit të propozuar kushtetues nga Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese ftoi Avokatin e Popullit që të paraqiste parashtrimet e veta në lidhje me pranueshmërinë dhe themelësinë e amendamentit të propozuar. Parashtrimet janë publikuar në faqen e DHSK-së në Internet, në rubrikën e dokumentacionit gjyqësor publik.

Me gjithë vështirësitë që shkaktoi pandemia e KOVID-19, Zyra e Avokatit të Popullit vazhdoi me aktivitetet e veta komunikuese dhe ndërgjegjësuere gjatë gjithë vitit 2020. Me ndihmën e Njësisë për Informim dhe Komunikim me Publikun të Zyrës Administrative, Zyra e Avokatit të Popullit mori pjesë në një varg aktivitetesh me përfaqësues të shoqërisë civile në rajon, të organizuara në Internet në kuadër të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim.

4 | Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore

Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore siguron mbështetjen e nevojshme juridike dhe operative për DHSK-në dhe ZPS-në përmes zyrave dhe njësive të veta, të cilat janë: Njësia për Administrimin e Gjykatës, Njësia e Përkthimit, Zyra e Mbrojtjes, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve dhe Njësia e Paraburgimit.

Gjatë vitit 2020, Seksioni i Shërbimeve Gjyqësore kryesisht u mor me hartimin e disa paketave të rregulloreve dhe me sigurimin e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të nevojshme për fillimin e procedurave publike.

Këtë vit u zhvilluan procedura para disa paneleve, përkatësisht panelit të Gjykatës Kushtetuese, panelit të Apelit, Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe Gjykatësit të Vetëm, në tri çështje gjyqësore të ndryshme me gjithsej pesë të akuzuar dhe dy të dyshuar (tani të akuzuar). Njësi të ndryshme të Seksionit të Shërbimeve Gjyqësore ofruan mbështetje në të gjitha aspektet e procedurave, ku përfshihen përkthimi në tri gjuhët zyrtare të gjykatës dhe aspektet teknike në lidhje me transmetimin e drejtpërdrejtë të tyre përmes faqes së DHSK-së në Internet.

4.1 | Njësia për Administrimin e Gjykatës

Njësia për Administrimin e Gjykatës (NJAGJ) administron dokumentacionin gjyqësor të DHSK-së, ku përfshihen të gjitha parashtimet dhe provat, dhe ndihmon në kryerjen e procedurave gjyqësore.

Gjatë vitit 2020, kjo Njësi u përqendrua kryesisht në përfundimin e përgatitjeve në lidhje me sallën e gjyqit, si dhe në përsosjen dhe zgjerimin e sistemit elektronik të administrimit të gjykatës Legal Workflow. Përmirësimet e vetë softuerit përfshinin harmonizimin me softuerin e njësisë së përkthimit, si edhe thjeshtëzimin e procedurës së nxjerrjes elektronike të dokumenteve. Me fillimin e procedurave, ekipeve të mbrojtjes iu autorizua qasje në softuer si dhe u organizuan trajnime për përdorimin e softuerit si për mbrojtësit e specializuar, ashtu edhe për punonjësit e DHSK-së.

Duke qenë se në rrethana të pandemisë së COVID-19, publiku më i gjerë nuk kishte qasje në galerinë për publikun, u rrit rëndësia e transmetimit të procedurave në faqen e DHSK-së në Internet.

Aspektet teknike të transmetimit të organizuar nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, veçanërisht instalimi i kamerave, realizimi, videomiksi, ngjyrat dhe ndriçimi janë vlerësuar si shembull i praktikave më të mira në këtë fushë.

Gjatë vitit 2020 u mbajtën shtatë seanca të paraqitjes së parë, një seancë e përbashkët e paraqitjes vijuese dhe e konferencës për ecurinë e çështjes, dy paraqitje të para, katër konferenca për ecurinë e çështjes dhe një seancë e mbyllur ex parte. Niveli i klasifikimit të disa dokumenteve u ndryshua për të mundësuar publikimin e tyre në Internet, si dhe u rrit dukshëm numri i përgjithshëm i parashtimeve. Gjithsej u përpunuan 807 parashtime dhe përkthime të tyre, pa llogaritur shtojcat, si dhe 45 transkripte në të tri gjuhët zyrtare të DHSK-së.

Në vitin 2020, Njësia për Administrimin e Gjykatës përpunoi gjithsej 807 parashtime dhe përkthime të tyre, pothuajse 1.500 kërkesa për përkthim, 70 dokumente të paketave të rregulloreve dhe tri apele të punonjësve.

4.2 | Njësia e Përkthimit

Njësia e Përkthimit ofron përkthime me gojë e me shkrim në tri gjuhët zyrtare të DHSK-së. Njësia e Përkthimit kryen punën e vet jo vetëm në selinë e gjykatës në Hagë, por edhe në misione jashtë vendit, si edhe në mbarë botën përmes mediave virtuale. Njësia e Përkthimit ofron shërbime përkthimi për të gjitha institucionet - Dhomat, ZPS-në dhe Zyrën Administrative.

Në vitin 2020, Njësia e Përkthimit përktheu një spektër të gjerë materiale, ndër të tjera parashtrime, materiale të Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, paketa dokumentesh themelore normative, dokumente të lidhura me procesin e pjesëmarrjes së viktimave, dhe publikime të tjera të gjykatës.

Njësia e Përkthimit gjithashtu ka ofruar mbështetje të shtuar për ZPS-në gjatë vitit 2020. Në bashkëpunim me Njësinë për Administrimin e Gjykatës dhe një ekspert për programe kompjuterike, Njësia e Përkthimit kontribuoi në krijimin e programit kompjuterik për automatizimin e kërkesave të përkthimit.

Me fillimin e proceseve, Njësia e Përkthimit jo vetëm që ofroi shërbime të përkthimit simultan në të tri gjuhët zyrtare të gjykatës, por edhe mori pjesë në testimet e shumta të pajisjeve teknike në sallën e gjyqit dhe në qendrën për mediat.

Në vitin 2020, Njësia e Përkthimit përktheu mbi 8.200 faqe në shqip, serbisht, anglisht dhe gjuhë të tjera.



4.3 | Zyra e Mbrojtjes

Zyra e Mbrojtjes (ZM) administron sistemin e ndihmës juridike për përfaqësimin e të dyshuarve dhe të akuzuarve të cilët nuk zotërojnë, ose zotërojnë pjesërisht mjete financiare për pagesën e përfaqësimit juridik të tyre. Në kuadër të këtij funksioni, Zyra e Mbrojtjes administron gjithashtu edhe Listën e Mbrojtësve që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit para DHSK-së. Versioni më i fundit i Listës së Mbrojtësve të Specializuar që plotësojnë kriteret për ushtrimin e profesionit para DHSK-së u publikua në nëntor. Lista aktuale përmban 105 mbrojtës të specializuar dhe procesi i parashtrimit të kërkesës për praninë në listë vazhdon të jetë i hapur.

Zyra e Mbrojtjes është neutrale dhe nuk luan kurrfarë roli në procedimin konkret të çështjeve gjyqësore në DHSK. Në shtator, pas këshillimeve me Kryetaren, Administratorja miratoi Rregulloren e Ndhmës Juridike të DHSK-së.

Me fillimin e procedurave publike në vitin 2020, Zyra e Mbrojtjes u kujdes që të gjithë personat e transferuar në objektin e paraburgimit të DHSK-së të kenë nga një mbrojtës sa më parë që është e mundshme. Menjëherë pas mbërritjes së një të dyshuari apo të akuzuari në objektin e paraburgimit, shefi i Zyrës së Mbrojtjes takoj me të dhe i shpjegonte të drejtën për të pasur një mbrojtës dhe të drejtën për ndihmë juridike. Të paraburgosurve gjithashtu iu shpjegua edhe e drejta përfaqësimi nga një mbrojtës kujdestar, deri në emërimin ose caktimin nga Administratorja të mbrojtësit të zgjedhur prej tyre.

Në proceset publike aktuale, Administratorja ka emëruar pesë mbrojtës për pesë të akuzuar, dhe ka miratuar tetë bashkëmbrojtës si anëtarë të ekipeve

të mbrojtjes. Mbrojtësit e emëruar paguhën nga të akuzuarit me mjete të veta. Gjithashtu, Administratorja miratoi ndihmë juridike për dy të akuzuar, u caktoi atyre nga një mbrojtës, si dhe miratoi një bashkëmbrojtës në ekipin e njërit mbrojtës. Mbrojtësit e caktuar dhe bashkëmbrojtësit në ekipet e tyre paguhën përmes sistemit të ndihmës juridike të DHSK-së. Ata caktohen kushtimisht, deri në përfundimin e vlerësimit të varfërisë që kryhet. Aktualisht, të gjithë ekipet mbrojtëse janë duke rekrutuar anëtarë të ekipeve.

Gjatë vitit 2020, Zyra e Mbrojtjes mori një numër kërkesash për caktimin ose emërimin e një mbrojtësi, nga të dyshuar që do të intervistoheshin nga ZPS-ja. Administratorja emëroi 16 mbrojtës dhe miratoi dy bashkëmbrojtës për këta të dyshuar. Mbrojtësit e emëruar dhe bashkëmbrojtësit paguhën nga vetë të dyshuarit. Gjithashtu, Administratorja caktoi dy mbrojtës dhe miratoi dy bashkëmbrojtës. Mbrojtësit e caktuar paguhën përmes sistemit të ndihmës juridike të DHSK-së. Ata caktohen kushtimisht, deri në përfundimin e vlerësimit të varfërisë që kryhet.

Në bashkëpunim me Zyrën e Pjesëmarrjes së Viktimave, Zyra e Mbrojtjes ka përfunduar përgatitjet për kalimin efikas të mbrojtësve dhe ekipeve të tyre në sistemin e DHSK-së, ndër të tjera duke u mundësuar atyre qasje në sistemin elektronik të administrimit të gjykatës Legal Workflow. Gjithashtu, në bashkëpunim me Njësinë e Administrimit të Informacionit dhe Njësinë e Teknologjisë së Informacionit, Zyra e Mbrojtjes krijoi faqen për mbrojtësit në Intranet (faqja e brendshme e DHSK-së në Internet), e cila përmban informacion të gjithanshëm që mund t'i ndihmojë në përgatitjen e mbrojtjes.

Rregullorja e Ndhmës Juridike ngërthen parimet themelore të parapara në Ligjin tonë dhe standardet universale në drejtësinë penale, duke garantuar të drejtën e të akuzuarve për gjykim të drejtë, që përfshin edhe të drejtën për mbrojtje efektive.

Rregullorja e ndihmës juridike

Rregullorja pasqyron praktikat më të mira të standardeve të ndihmës juridike, duke garantuar respektimin e parimeve të gjykimit të drejtë, mishëruar në Kushtetutën e Kosovës dhe në Ligj, dhe duke mundësuar miradministrim financiar të burimeve të skemës së ndihmës juridike.

Të dyshuarve ose të akuzuarve në DHSK të cilët provojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë për mbrojtjen e tyre dhe nuk marrin ndihmë juridike në mënyra të tjera, u miratohet ndihmë juridike e plotë ose e pjesshme për pagesën e avokatit që zgjedhin vetë i cili plotëson kushtet e pranimit në listën e mbrojtësve të DHSK-së. Ndihma juridike mbulon pagesën e mbrojtësit dhe anëtarëve të ekipit të mbrojtësit dhe i paguhet drejtpërsëdrejti mbrojtësit.

Administratorja llogarit ndihmën juridike në këshillim me panelin kompetent dhe mbrojtësit duke mbajtur parasysh nivelin e kompleksitetit të çështjes dhe të shërbimeve të ofruara nga mbrojtësi në çdo fazë të procesit, ku përfshihen faza para aktakuzës, faza e procedurës paraprake, faza e gjykimit, faza e apelit në shkallë të dytë dhe faza e apelit në shkallë të tretë. Gjithashtu kompensohen deri në një shumë të caktuar edhe shpenzimet që mund të dalin gjatë hetimeve ose si pasojë e nevojës për përkthime.

Rregullorja parashtron me transparencë mënyrën se si bëhet kërkesa për ndihmë juridike dhe çfarë dokumentesh duhet t'i dorëzohen Zyrës së Mbrojtjes. Më konkretisht, kërkesës për ndihmë juridike i duhet bashkëngjitur edhe deklarimi i mjeteve financiare. Zyra e Mbrojtjes kryen një verifikim rrënjësor të mjeteve financiare të parashtruesit të kërkesës për të përcaktuar nëse duhet miratuar ndihmë juridike e plotë ose e pjesshme. Kërkesa për ndihmë juridike refuzohet nëse parashtruesi i kërkesës nuk bashkëpunon ose jep informacion të rremë. Në qoftë se nuk pajtohet me vendimin e Administratores, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ta apelojë vendimin para një paneli gjykatësish.

Në Rregullore përcaktohet shuma maksimale e honorarit të ndihmës juridike dhe shpenzime të tjera që mund të kompensohen pas dorëzimit të faturave. Rregullorja përmban edhe procedurën e mbikëqyrjes dhe monitorimit prej Zyrës së Mbrojtjes të shpenzimit të ndihmës juridike.

Në rregullore gjithashtu përcaktohet edhe sistemi i pagesave për Mbrojtësit e Viktimave dhe anëtarët e ekipeve të tyre dhe zbatohet mutatis mutandis për Mbrojtësit e Viktimave.

4.4 | Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave

Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave (ZPV) administron sistemin e pjesëmarrjes së viktimave. Për të mundësuar këtë proces, ajo administron Listën e Mbrojtësve të Viktimave që plotësojnë kriteret e përfaqësimit para DHSK-së, si edhe sistemin e pagesave për përfaqësimin juridik të viktimave pjesëmarrëse. Lista publike aktuale përmban 92 mbrojtës që janë të kualifikuar t'i përfaqësojnë viktimat. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave gjithashtu u ofron viktimave ndihmë dhe këshilla në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat marrin pjesë.

Gjatë vitit 2020, Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave vazhdoi me aktivitete të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, kryesisht virtuale, duke iu përshtatur vështirësive që shkaktoi pandemia e KOVID-19. Ajo, ndër të tjera, organizoi tryeza të rumbullakëta në Internet me gazetarë, përgatiti dhe publikoi një videomaterial në lidhje me procesin e parashtrimit të kërkesës për pranim si viktimë pjesëmarrëse, si dhe krijoi faqen e vet brenda faqes së DHSK-së në Internet, e cila përmban informacion për procesin e parashtrimit të kërkesave për viktimat pjesëmarrëse. Videomateriali në lidhje me procesin e parashtrimit të kërkesës për pranim si viktimë pjesëmarrëse është

transmetuar për dy javë rresht në kohët e shikueshmërisë më të lartë në 12 kanale televizive në Kosovë.

Konfirmimi i aktakuzës së parë para DHSK-së dhe publikimi i saj në shtator shënoi fillimin e procesit të parashtrimit të kërkesave të viktimave për pjesëmarrje në procese gjyqësore. Publikimi edhe i një aktakuze tjetër e ka zgjeruar grupin e viktimave me të drejtë pjesëmarrjeje. Zyra e Pjesëmarrjes së Viktimave ka marrë kërkesa zyrtare për të dyja çështjet, si dhe disa kërkesa për informacion për procesin e kërkesave.

Viktimat që marrin pjesë në procese gjyqësore para DHSK-së gëzojnë të drejta të caktuara, ndër të cilat njoftimi, pranimi dhe zhdëmtimi. Viktimat të cilave u miratohet pjesëmarrje në proceset në DHSK do të grupohen në një ose më shumë grupe. Secili grup merr pjesë në proces përmes mbrojtësit të viktimave. Mbrojtësi i viktimave mund të jetë i pranishëm në seanca gjyqësore dhe i informon viktimat gjatë të gjithë procesit gjyqësor. Mbrojtësi i viktimave merr mendimet e viktimave, dëgjon shqetësimet e tyre, dhe ua paraqet ato gjykatësve përkatës.

Kush është viktimë pjesëmarrëse para DHSK-së

Një person fizik që ka pësuar dëm fizik, material apo mendor si pasojë e drejtpërdrejtë e një vepre penale të pretenduar në një aktakuzë të konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake, mund të fitojë statusin procedural të viktimës pjesëmarrëse në proceset gjyqësore para DHSK-së.

Kur një aktakuzë konfirmohet dhe bëhet publike, personat mund të parashtrojnë kërkesë për pranim si viktimë pjesëmarrëse nga gjykatësi i procedurës paraprake ose nga trupi gjyqësor.

4.5 | Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve

Zyra për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve (ZMMD) është përgjegjëse për mbrojtjen e sigurisë, mirëqenies fizike dhe psikologjike, dinjitetit dhe privatisë së dëshmitarëve, viktimave pjesëmarrëse në procese gjyqësore dhe, sipas rastit, të personave të tjerë të rrezikuar për shkak të dëshmive të dhëna nga dëshmitarët. Ajo gjithashtu ndihmon dhe mundëson paraqitjen e tyre të sigurt dhe me kohë para DHSK-së, kurdo që kërkohet. Kjo nënkupton ofrimin e të gjithë ndihmës administrative dhe logjistike dëshmitarëve që paraqiten para DHSK-së, përfshirë informimin e dëshmitarëve për çfarëdo çështje që ka të bëjë me sigurinë e tyre, natyrën e procedurave në sallën e gjyqit, planimetrinë e sallës së gjyqit, pjesëmarrësit dhe rolin e tyre, dhe të drejtat dhe detyrimet e dëshmitarëve në procese gjyqësore.

Me intensifikimin e aktiviteteve në vitin 2020, u rrit edhe vëllimi i punës operative të kësaj Zyre në të gjitha aspektet, përfshirë mbrojtjen e dëshmitarëve, mbështetjen psiko-sociale dhe format e tjera të ndihmës për dëshmitarët. Kjo pritet të vazhdojë me vijimin e mëtejshëm të proceseve gjyqësore.

Objektivat kyçe të Zyrës për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve për vitin 2020 kanë përfshirë ruajtjen dhe konsolidimin e kapaciteteve operative për mbrojtjen, mbështetjen dhe ndihmimin e viktimave, dëshmitarëve dhe personave të tjerë të rrezikuar, si dhe ruajtjen e aftësisë për të mbrojtur në mënyrë efektive personat në rrezik të lartë, në bashkëpunim me partnerë shtetërorë dhe ndërkombëtarë, sipas nevojës.

4.6 | Njësia e Paraburgimit

Administratorja është përgjegjëse për drejtimin dhe administrimin e funksionit të paraburgimit dhe të objektit të paraburgimit të DHSK-së në përputhje me standardet ndërkombëtare. Administratorja e ushtron këtë funksion përmes Njesisë së Paraburgimit, e cila drejton dhe administron objektin e paraburgimit të DHSK-së që gjendet brenda një burgu holandez në Hagë.

Rregullorja e Paraburgimit u miratua në shtator, kurse përdorimi i objektit të paraburgimit u mundësua përmes një marrëveshjeje me Shërbimin Holandez të Burgjeve dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme të Holandës. Në nëntor, në objektin e paraburgimit të DHSK-së kishte shtatë të paraburgosur.

Njësia e Paraburgimit përkujdeset që kushdo që mbahet në paraburgim nga DHSK-ja të mbahet në

përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare, praktikat më të mira të paraburgimit dhe ligjin në fuqi.

Një tjetër detyrë kyçe e kësaj njësie është të sigurojë që të paraburgosurit të jenë në gjendje të marrin pjesë në procedura para DHSK-së në mënyrë të sigurt. Gjatë pandemisë së KOVID-19, kjo ka përfshirë mundësimin e pjesëmarrjes së të paraburgosurve në procedura nga distanca, përkatësisht nga objekti i paraburgimit, kur është e domosdoshme.

Zbatimi i masave për zbutjen e rrezikut të KOVID-19 në kontekstin e administrimit të paraburgimit është pasqyruar në Rregulloren e Paraburgimit dhe në administrimin e përditshëm të objektit të paraburgimit.



Rregullorja e paraburgimit

Rregullorja e paraburgimit rregullon vizitat e të paraburgosurve dhe komunikimin e të paraburgosurve me mbrojtësit dhe familjet e tyre. Ajo gjithashtu rregullon regjimin disiplinor dhe procedurën e ankesave. Rregullorja e Paraburgimit i përmbush ose i tejkalon standardet më të larta ndërkombëtare, përfshirë veçanërisht Rregulloren Evropiane të Burgimit dhe Rregullat Standarde Bazë të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e Të Burgosurve, që njihen më gjerë si Rregullorja e Nelson Mandelës.

Rregullorja e Paraburgimit është hartuar në këshillim me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq, i cili mund të kryejë inspektime të rregullta, të palajmëruara dhe të pavarura të objektit të paraburgimit për të këqyrë kushtet e paraburgimit dhe për të garantuar respektimin e të drejtave të njeriut, të së drejtës ndërkombëtare dhe të standardeve të pranuar të trajtimit. Gjithashtu, edhe Avokati i Popullit i DHSK-së mund të hyjë në çdo kohë dhe pa paralajmërim dhe të inspektojë objektin e paraburgimit për të vlerësuar kushtet e paraburgimit.

5 | Seksioni i Administratës

Seksioni i Administratës ofron ekspertizë dhe mbështetje administrative e teknike për DHSK-në dhe ZPS-në përmes njësive të saj, të cilat janë: Njësia e Burimeve Njerëzore, Njësia e Teknologjisë së Informacionit, Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme, Njësia e Sigurisë, Njësia e Financave dhe Buxhetit, dhe Njësia e Prokurimit.

Në vitin 2020, puna e Seksionit të Administratës u përqendrua në zbatimin e masave për zbutjen e rrezikut të COVID-19 dhe në përgatitjet për procedurat publike.

Puna në të dy këto fusha u shtri në të gjitha objektet fizike të DHSK-së, si dhe në sferën virtuale dhe teknike. Rekrutimi i punonjësve për të përmbushur nevojat operative të organizatës vazhdoi edhe më tutje.

Gjithashtu u krye punë e rëndësishme në fushën e financave dhe buxhetit, prokurimit, Regjistrin të DHSK-së mbi Rreziqet dhe përgatitjeve për zbatimin e sistemit të planifikimit të burimeve të institucionit (ERP).

5.1. | Njësia e Burimeve Njerëzore


Njësia e Burimeve Njerëzore (NJBNI) ofron mbështetje, këshilla dhe shërbime për të gjithë punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së. Gjatë vitit 2020, kjo njësi vazhdoi me kryerjen e detyrave të veta dhe, ndër të tjera: ndihmoi procesin e rekrutimit; administroi dhe këshilloi punonjësit lidhur me një sërë çështjesh në lidhje me personelin - nga kompensimet dhe përfitimet, e deri tek mirëqenia dhe siguri shëndetësor; u ofroi mbështetje punonjësve dhe kuadrit udhëheqës gjatë procesit të vlerësimit të punës së punonjësit; dhe organizoi trajnime dhe aktivitete të tjera të zhvillimit personal dhe profesional të punonjësve. Njësia gjithashtu luajti rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes për punonjësit gjatë pandemisë.

Gjatë vitit 2020 u shpallën tri Ftesa për Aplikime: afati përmbyllës i Ftesës së parë u vazhdua deri në fillim të shkurtit, i së dytës ishte nëntori, dhe i së tretës (për praktikë profesionale) tetori. U përpunuan gjithsej 3.880 aplikime, në bazë të së cilave në vitin 2020 u punësuan 65 punonjës të rinj (32 meshkuj dhe 33 femra) dhe 14 praktikantë (13 meshkuj dhe një femër). Numri i gjithsejtë i punonjësve u rrit nga 203 në vitin 2019 në 244 në fund të vitit 2020.


Numri i punonjësve të emëruar për punësim nga shtetet anëtare mbeti pothuajse i pandryshuar, me një ulje të vogël nga 14 në 12 punonjës të emëruar nga shtetet anëtare të BE-së (Finlandë, Gjermani, Hungari, Irlandë, Maltë dhe Britani e Madhe) dhe një shtet i tretë kontribues (Shtetet e Bashkuara të Amerikës).

Përfaqësimi i punonjësve në DHSK dhe ZPS sipas shteteve

31 dhjetor 2020



Numri i gjithsejtë i punonjësve në DHSK dhe ZPS



Automatizimi dhe teknologjitë e reja janë kyçe për efikasitetin dhe saktësinë në punën e shërbimeve të punësimin. Në tetor 2020, DHSK-ja dhe ZPS-ja për herë të parë shpallën Ftesat për Aplikime përmes platformës së jashtme të shpalljeve Goalkeeper, me çka u sigurua automatizimi i pjesshëm i rrjedhjes së informacionit për vende të lira pune.

Gjithashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore organizoi ose mundësoi mbi 20 kurse për trajnim dhe zhvillim, ndër të tjera nga fusha e menaxhimit dhe udhëheqjes, parandalimit të ngacmimit psikologjik dhe seksual, integritit të perspektivës gjinore, administrimit të punës, mirëqenies së punonjësve, dhe teknologjisë së informacionit. U ofruan gjithashtu edhe kurse

gjuhësore për mësimin e shqipës dhe serbishtes. Gjithashtu, për shkak të numrit gjithnjë e më të madh të punonjësve që punonin nga distanca, Njësia e Burimeve Njerëzore siguroi licenca për kurse dhe trajnime përmes Internetit për të gjithë punonjësit.

Në përputhje me detyrën e saj të kujdesit të duhur për punonjësit, gjatë gjithë vitit 2020 Njësia e Burimeve Njerëzore u ofroi punonjësve shërbime të këshillimit psikologjik dhe kujdesit për mirëqenie. Në bashkëpunim me Kabinetin e Administratores, Njësia e Burimeve Njerëzore rishikoi Rregulloren për Punonjësit dhe bëri disa ndryshime të rëndësishme, ndër të tjera në lidhje me administrimin e mungesave dhe racionalizimin e të drejtave.

5.2 | Njësia e Teknologjisë së Informacionit


Njësia e Teknologjisë së Informacionit (NJTI) ofron shërbime të sigurta të TI-së dhe audiovizuale në mbështetje të punës së DHSK-së.

Në vitin 2020, në rrethana të pandemisë së KOVID-19, Njësia e Teknologjisë së Informacionit u përball me sfidën e jashtëzakonshme të zhvendosjes së sigurt të pothuajse të gjithë punonjësve në një mjedis virtual pune, si dhe të vendosjes së lidhjeve të nevojshme, pajisjeve dhe programeve e aplikacioneve kompjuterike të dizajnuara posaçërisht për mundësimin e komunikimit nga distanca midis mjediseve të DHSK-së, objektit të paraburgimit dhe përdoruesve privatë. Puna e Njesisë së Teknologjisë së Informacionit përfshin një spektër të gjerë aktiviteteve të përditshme, ndër të cilat videotakimet e punonjësve, vizitat virtuale të të paraburgosurve me anëtarë të familjes, si dhe transmetimi i drejtpërdrejtë i procedurave gjyqësore nëpërmjet faqes së DHSK-së në Internet.

Njësia e Teknologjisë së Informacionit luajti rol të rëndësishëm edhe në përgatitjen e sallës së gjyqit për fillimin e procedurave. U kryen punë të rëndësishme teknike në formën e testimit dhe përmirësimit të pajisjeve në sallën e gjyqit, duke përfshirë përmirësimin e kapacitetit të funksionit të transmetimit dhe të faqes së Internetit, si edhe të pjesëmarrjes nga distanca në seanca gjyqësore. Për më tepër, Njësia e Teknologjisë së Informacionit u siguroi kompjuterë edhe të paraburgosurve, të përshtatur për nevojat e tyre.

Që me fillimin e procedurave publike ishte menjëherë e mundur që seancat gjyqësore, konferencat për shtyp dhe njoftimet e tjera të transmetohen elektronikisht në kohë reale dhe në të tri gjuhët zyrtare të DHSK-së.

Brenda vetëm një fundjave në mars, në përgjigje të rrethanave të shkaktuara nga pandemia e KOVID-19, Njësia e Teknologjisë së Informacionit arriti të mundësonte qasje nga distanca për tre herë më shumë punonjës, përkatësisht për 180 në krahasim me 60 të mëparshëm. Ky zgjerim i infrastrukturës u bë në përputhje me praktikën më të mirë për sigurinë e mjedisit të punës nga distanca. Deri në fund të vitit 2020, numri i personave që ishin në gjendje të punonin nga distanca arriti në mbi 300, shpeshherë me rreth 100 përdorues të njëkohshëm brenda ditës.



5.3 | Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme

Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme (NJAOSHP) është përgjegjëse për realizimin efikas dhe të efektshëm të shërbimeve mbështetëse për DHSK-në dhe ZPS-në. Kjo përfshin administrimin e pasurive të paluajtshme së bashku me shtetin pritës, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave dhe planifikimin e hapësirave të punës, me synimin e sigurimit të një mjedisi cilësor pune për punonjësit dhe vizitorët që vijnë në organizatë. Njësia është gjithashtu përgjegjëse për shërbime të tilla si furnizimi i mensës, pritja e vizitorëve dhe pastërtia. Ajo gjithashtu administron shërbimin e postës së rregullt dhe postës së sigurt, transportin, udhëtimet dhe logjistikën, si dhe punon ngushtësisht me Njësinë e Sigurisë dhe atë të Protokollit.

Edhe kjo Njësi ishte në vijën e parë të frontit kur është fjala për zbatimin e masave në lidhje me KOVID-19. Megjithëse pjesa më e madhe e punonjësve filluan me punë nga distanca, një pjesë e tyre duhej të vazhdonin të punonin në vetë mjediset e DHSK-së. Për ta mundësuar këtë, Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme, së bashku me drejtuesit, përpiloi dhe

zbatoi masa të përshtatshme për zbutjen e rrezikut, ndër të cilat ndryshimi dhe përshtatja fizike e mjediseve të ndërtesave në shumë aspekte.

Masat e zbutjes së rrezikut dhe të ndryshimit dhe përshtatjes së mjediseve që zbatoi kjo Njësi ishin të rëndësishme kyçe për mbajtjen e më shumë seancave publike në sallën e gjyqit gjatë pandemisë, në të cilat ishin të pranishëm si pjesëtarë të publikut në galerinë publike, ashtu edhe përfaqësues të mediave në dhomat e përgatitura posaçërisht për mediat.

Me gjithë nevojën e vazhdueshme të zbatimit të masave në lidhje me pandeminë, Njësia për Administrimin e Objekteve dhe Shërbime të Përgjithshme vazhdoi me përmirësimin dhe thjeshtimin e mëtejshëm të proceseve që lidhen me objektiva më të përgjithshme. Në këtë kontekst, Njësia forcoi marrëdhëniet e punës me shtetin pritës në nivel operativ, ndër të tjera me Agjencinë qendrore të Qeverisë për pasuri të paluajtshme, që rezultoi në nënshkrimin e marrëveshjes për shërbime dhe mirëmbajtje të vazhdueshme të objekteve të DHSK-së dhe ZPS-së në të ardhmen.



Njoftimet për masat lidhur me KOVID-19 në gjykatë

5.4 | Njësia e Sigurisë

Njësia e Sigurisë (NJS) është përgjegjëse për sigurinë e punonjësve dhe objekteve të DHSK-së, si dhe të të gjithë personave të tjerë që ndodhen në mjediset e DHSK-së. Punonjësit e Njesisë së Sigurisë gjithashtu kryejnë detyrat e policisë gjyqësore, drejtojnë masat e sigurisë gjatë seancave gjyqësore dhe kryejnë operacionet e transferimit në përputhje me udhëzimet e Administratores.

Gjatë gjithë vitit 2020, Njësia e Sigurisë ka qenë vazhdimisht e angazhuar në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave në fuqi të shtetit pritës në lidhje me KOVID-19. Falë një angazhimi të tillë për zvogëlimin e rrezikut operativ dhe rrezikut ndaj vazhdueshmërisë së punës u mundësua edhe realizimi i plotë i aktiviteteve që lidhen me mandatin.

Gjatë vitit 2020, Njësia e Sigurisë kreu me sukses transferimin e shtatë të paraburgosurve në objektin e paraburgimit të DHSK-së, si dhe transferimin e tyre për t'u paraqitur para Gjykatësit të Procedurës Paraprake, përkatësisht Gjykatësit të Vetëm. Koordinimi me shtetin pritës dhe shtetet e tjera ka qenë i gjithanshëm gjatë këtyre operacioneve. Për më tepër, këto operacione Njësia e Sigurisë arriti t'i kryente me sukses duke i respektuar plotësisht masat në lidhje me KOVID-19 dhe në përputhje me praktikatat më të mira në këtë kontekst. Profesionalizmi i ekipeve për transferim të Njesisë së Sigurisë është vlerësuar në gjyq edhe nga disa të paraburgosur.

Gjatë vitit 2020, u rrit numri i punonjësve në këtë Njësi, për të përmbushur nevojat që lidhen me fillimin e procedurave publike, si dhe u ndryshuan dhe përshtatën procedurat operative të brendshme në mënyrë që detyrat e mbajtjes në ruajtje të kryhen në përputhje të plotë me masat e kontrollit në fuqi dhe me praktikatat më të mira në lidhje me pandeminë e KOVID-19.

Gjithashtu, koordinimi në aspektin e udhëtimeve zyrtare vazhdoi me intensitetin e njëjtë. Në fakt, korniza e menaxhimit të rrezikut gjatë udhëtimit u përmirësua përmes rishikimit të rregulloreve të brendshme për trajnimet e detyrueshme.

Njësia e Sigurisë vazhdon të zhvillojë dhe kultivojë bashkëpunim të gjithanshëm me partnerë shtetërorë dhe ndërkombëtarë, duke kontribuar në këtë mënyrë në monitorimin dhe vlerësimin efektiv të kërcënimeve, si dhe sigurimin e mbështetjes profesionale për mbrojtjen dhe sigurinë e veprimtarive kyçe të DHSK-së dhe ZPS-së.

Ekipeve të përcjelljes së Sigurisë janë përgjegjëse për transferimin e sigurt të të paraburgosurve në mënyrë që është në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut. Anëtarët e ekipeve të përcjelljes kalojnë trajnim të specializuar për t'u përgatitur për detyrat kyçe të tyre.



Masat e kontrollit gjatë hyrjes në gjykatë

5.5 | Njësia e Financave dhe Buxhetit

Njësia e Financave dhe Buxhetit (NJFB) mbështet Administratoren në administrimin financiar dhe përdorimin e fondeve që i janë akorduar DHSK-së, në përputhje me rregullat dhe rregulloret financiare të brendshme dhe të BE-së.

Gjatë vitit 2020, Njësia e Financave dhe Buxhetit punoi për të siguruar një administrim efikas dhe autonom, përmes zbatimit të një sërë sistemesh, rregullash dhe procedurash që sigurojnë përdorimin e duhur dhe miradministrimin financiar të fondeve. Në lidhje me këtë, gjatë vitit 2020 Administratorja nxori ose përditësoi më shumë se pesë direktiva administrative, të cilat rregullojnë aspekte kyçe të cikleve financiare të DHSK-së dhe ZPS-së.

Si përgjigje ndaj mjedisit të punës nga distanca të krijuar nga KOVID-19, Njësia e Financave dhe Buxhetit menjëherë u përshtat për të mundur shpërndarjen dhe nënshkrimin elektronik të dokumenteve financiare.

DHSK-ja vazhdoi të administrojë fondet e akorduara nga shtetet anëtare të BE-së gjatë vitit 2020, në përputhje me buxhetin e miratuar, shuma e gjithsejtë e të cilit ishte 67.535.004 euro për periudhën 15 qershor 2018 - 14 qershor 2020, dhe 42.900.000 euro për periudhën 15 qershor 2020 - 14 qershor 2021.

Përveç fondeve të pakthyeshme nga BE-ja, DHSK-ja administroi edhe fonde në shumën prej 80.000.000 korona norvegjeze të dhuruara nga qeveria norvegjeze si mbështetje për zhvendosjen e gjykatës në mjediset e reja, dhe 144.700 euro nga qeveria zvicerane për aktivitetet e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim të DHSK-së gjatë 2020 dhe 2021.

DHSK-ja ka rregulla dhe procedura financiare tejet rigorozë. Në përputhje me marrëveshjen për subvencionim, një firmë e jashtme e auditimit kryen rregullisht verifikime të pavarura të shpenzimeve të llogarive financiare. Si institucione të financuara nga BE-ja, DHSK-ja dhe ZPS-ja gjithashtu i nënshtrohen auditimit jo të drejtpërdrejtë edhe nga Gjykata Evropiane e Auditorëve dhe Shërbimi i Auditimit të Brendshëm i Komisionit Evropian. Gjatë auditimeve dhe verifikimeve të kryera në vitin 2020 nuk u identifikua asnjë parregullsi. Në fund të çdo periudhe raportimi buxhetor, llogaritë përfundimtare dhe raportet e verifikimit të shpenzimeve i dorëzohen Shërbimit të Komisionit Evropian për Instrumente të Politikës së Jashtme (IPJ).

Në vitin 2020, Marrëveshja e dytë për subvencionim e nënshkruar midis Administratores dhe Komisionit Evropian për periudhën 15 qershor 2017 - 14 qershor 2018, dhe Marrëveshja për subvencionim e nënshkruar midis Administratores dhe qeverisë zvicerane për aktivitetet e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, u përmbyllën me sukses dhe nuk u konstatua asnjë parregullsi. Gjithashtu u përgatitën dhe shpërndanë raportet përfundimtare për Marrëveshjen e tretë për subvencionim, të nënshkruar midis Administratores dhe Komisionit Evropian për periudhën 15 qershor 2018 - 14 qershor 2020, si dhe Marrëveshjen për subvencionim të nënshkruar midis Administratores dhe qeverisë norvegjeze për mbështetjen e zhvendosjes së gjykatës në mjediset e reja.

Në vitin 2020, Njësia e Financave dhe Buxhetit vijoi të sigurojë përdorimin e duhur dhe miradministrimin financiar të fondeve.

5.6 | Njësia e Prokurimit

Njësia e Prokurimit është përgjegjëse për të gjitha prokurimet e DHSK-së dhe ZPS-së dhe për kontraktimin e furnizimeve, shërbimeve dhe punimeve. Përveç kësaj, Njësia e Prokurimit siguron që DHSK-ja dhe ZPS-ja të respektojnë rregullat e BE-së në veprimet e tyre të prokurimit. Gjithashtu, ajo ndihmon dy institucionet me administrimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe me organizimin e trajnimeve të rregullta për punonjësit dhe përdoruesit e buxhetit në lidhje me procesin e prokurimit dhe administrimin e kontratave dhe përgjegjësitë përkatëse.

Sikurse në rastin e shumë njësive të tjera, edhe puna e Njesisë së Prokurimit në vitin 2020 kryesisht u përqendrua në zbatimin e masave për zbutjen e rrezikut të përhapjes së KOVID-19 dhe përgatitjet përfundimtare lidhur me proceset gjyqësore. Me fillimin e punës nga distanca në mars, brenda një kohe të shkurtër, Njësia e Prokurimeve ia përshtati

ciklet e prokurimit situatës së re. Nga mbi 340 veprime prokurimi të ndërmarra nga Njësia e Prokurimit gjatë vitit 2020, më shumë se 120 prej tyre rezultuan në lidhje kontratash me vlerë të përbashkët prej 7,3 milion euro. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre kontratave kishin të bënin me fillimin e proceseve gjyqësore. Përgjithësisht, numri i kontratave të lidhura në vitin 2020, si edhe vlera e tyre e përbashkët, ishin më të larta në krahasim me vitin e mëparshëm.

Në vitin 2020 u arrit përparim i konsiderueshëm në procedurat lidhur me një sërë tenderësh më të mëdhenj. U finalizuan veprimet e prokurimit për zbatimin e integruar të sistemit të planifikimit të burimeve të institucionit (ERP) dhe u nënshkrua kontrata e zbatimit. Gjithashtu, u aprovua për tenderim paketa gjithëpërfshirëse e sigurimeve të DHSK-së.

Në vitin 2020, Njësia e Prokurimeve u angazhua në disa procese në mbështetje të aktiviteteve lidhur me fillimin e procedurave publike.

6 | Zyra e Auditimit

Auditimi i brendshëm është pjesë përbërëse e administrimit dhe llogaridhënies institucionale të DHSK-së dhe ZPS-së. Audituesi i brendshëm kryen auditime të shumta dhe ia raporton konstatimet Administratores. Në punën e vet, audituesi u përmbahet standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe rregulloreve financiare të BE-së, dhe propozon masa për përmirësimin e administrimit.


Gjatë vitit 2020, në përputhje me planin e auditimit të brendshëm, audituesja e brendshme e DHSK-së kreu tetë auditime, ndër të tjera të subvencioneve të marra nga qeveria norvegjeze dhe ajo zvicerane, të kontributeve në fondin e kursimeve, si dhe të shpenzimeve. Gjatë vitit 2020, ajo kreu gjithashtu edhe tetë auditime vijuese.

Përveç detyrave të auditimit, audituesja e brendshme u mor edhe me aktivitete në lidhje me zvogëlimin e rreziqeve në zyrat dhe njësitë e DHSK-së, si dhe me rishikimin e Strategjisë kundër mashtrimeve.

Detyra e Zyrës së Auditimit është të mbështesë Administratoren në sigurimin e miradministrimit financiar. Kjo arrihet duke vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe objektive funksionimin dhe sistemin e kontrollit të brendshëm të institucionit dhe duke dhënë vlerësime, analiza dhe rekomandime për forcimin e mëtejshëm të administrimit dhe kontrollit.



Integrimi i perspektivës gjimore në DHSK dhe ZPS



Integrimi i perspektivës gjinore në DHSK dhe ZPS

Drejtuesit e Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) promovojnë një mjedis të udhëheqjes gjithëpërfshirëse, me synimin që të gjithë punonjësit të ndjehen të vlerësuar, të trajtohen në mënyrë të drejtë, dhe t'u mundësohet të zhvillohen profesionalisht dhe të jenë të suksesshëm. Integrimi i perspektivës gjinore është strategji gjithëpërfshirëse që zbatohet nga institucionet për të garantuar

përfshirjen e interesave të të dy gjinive, me qëllimin përfundimtar të fuqizimit të barazisë gjinore. Kjo strategji përdoret për të përfshirë aspektin gjinor në rregullat dhe rregulloret e brendshme dhe nënkupton zbatimin e masave konkrete për rritjen e përqindjes së femrave të punësuar në DHSK dhe ZPS, për shembull, në fushën e sigurisë, ku tradicionalisht ato janë shumë më pak të përfaqësuara se meshkujt.

1. | Personi i kontaktit për çështje gjinore

Personi i kontaktit për çështje gjinore është një post i ri pranë Kabinetit të Administratores, i krijuar në vitin 2020. Personi i kontaktit për çështje gjinore angazhohet për promovimin dhe fuqizimin e një mjedisi gjithëpërfshirës pune në DHSK dhe ZPS, duke përmirësuar ekspertizën brenda institucionit. Personi i kontaktit për çështje gjinore përfaqëson institucionin në takimet me këshilltarë dhe persona të kontaktit për çështje gjinore të Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm, në të cilat shkëmbehen praktikatat më të mira, mendimet dhe idetë, dhe të cilat mundësojnë që DHSK-ja dhe ZPS-ja të jenë në hap me politikatat dhe rregulloret përkatëse në këtë fushë.

Me rastin e njëzetvjetorit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë, personi i kontaktit për çështje gjinore organizoi një tubim solemn në Internet për drejtuesit dhe punonjësit e DHSK-së dhe ZPS-së, për të festuar dhe nderuar gratë që janë burim i frymëzimit për ne.

Personi i kontaktit për çështje gjinore gjithashtu organizon trajnime për integrimin e perspektivës gjinore. Një trajnim i tillë u mbajt për drejtuesit e DHSK-së dhe ZPS-së në dhjetor, përmes aplikacionit Zoom. Për sa i përket punësimit, personi i kontaktit

Jemi me fat që punojmë në këtë gjykatë dhe në këtë kohë. Kryetarja jonë, gjykatëse Ekaterina Trendafilova, dhe Administratorja jonë, Dr. Fidelma Donlon, janë udhëheqëse të vërteta në këtë fushë. Deri më tani, vetëm një numër i vogël grash kanë qenë në pozita të larta drejtuese në gjykatat ndërkombëtare, dhe të kesh dy në të njëjtën kohë, pa vërejtur askush ndonjë dallim, paraqet përparim në këtë fushë, dhe kjo meriton të vihet në dukje.

Personi i kontaktit për çështje gjinore në shënimin e njëzetvjetorit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, tetor 2020.

për çështje gjinore do të jetë në kontakt me organizata ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe universitete dhe institucione të tjera përkatëse, në mënyrë që shpalljet për vende të lira pune të mund të qarkullohen sa më gjerësisht, në mbështetje të barazisë gjinore në DHSK dhe ZPS. Së fundmi, personi i kontaktit gjinor ka faqen e vet në Kosmos - faqja e brendshme e Internetit të DHSK-së dhe ZPS-së - ku publikon informacione, materiale dhe prezantime të rëndësishme në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore, si dhe informon punonjësit për prezantime të brendshme dhe të jashtme në të ardhmen dhe për mundësi trajnimi në këtë fushë.

2. | Politika proaktive e DHSK -së dhe ZPS-së në lidhje me barazinë gjinore

Me qëllim monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të përpjekjeve të DHSK-së dhe ZPS-së për rritjen e përfaqësimit të grave në dy institucionet, Njësia e Burimeve Njerëzore përgatit raporte mujore me të dhëna statistikore për punonjësit, ku përfshihen edhe të dhënat për përfaqësimin gjinor. Njësia e Burimeve Njerëzore raporton gjithashtu për numrin e grave që aplikojnë për vende pune, që hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë të kandidatëve dhe që marrin punën, si dhe për përfaqësimin e përgjithshëm gjinor në DHSK dhe ZPS. Për më tepër, Njësia e Burimeve Njerëzore monitoron zbatimin e Direktivës administrative për përzgjedhjen e punonjësve, e cila përcakton që në përbërje të paneleve përzgjedhëse duhet të ketë persona të shtetësive dhe gjinive të ndryshme, me përjashtim kur ekzistojnë arsye të forta për anashkalimin e këtij parimi.

Përkushtimi dhe masat proaktive të ndërmarra nga DHSK-ja dhe ZPS-ja për rritjen e përfaqësimit të grave kanë çuar në një përmirësim të konsiderueshëm. Për shembull, kur u formua Njësia e Sigurisë, përfaqësimi i grave në shërbime të ngjashme (si në polici shtetërore, ushtri, apo organizata të tjera ndërkombëtare) ishte afërsisht 10-12%. Gjatë viteve, numri i vogël i grave që aplikojnë për vende pune të sigurisë (afërsisht 10%) ka qenë një problem për realizimin e një përfaqësimi më të madh të grave në Njësinë e Sigurisë. Megjithatë, DHSK-ja dhe ZPS-ja vazhduan me angazhimin e tyre për rritjen e numrit të grave kandidatë për vende pune në Njësinë e Sigurisë, për të tejkaluar mesataren prej 12%. Aktualisht, 24% të punonjësve në Njësinë e Sigurisë janë gra.

Njësia e sigurisë arriti të rriste përfaqësimin e grave në radhët e veta duke zbatuar dy qasje kyçe: e para - përfshirja në të gjitha detyrat; dhe e dyta - sistemi i punës me rotacion, me të cilin për aq sa është e mundur minimizohet puna jashtë orarit të rregullt të punës dhe mundësohet stabilitet në planifikim. Kur është fjala për përfshirjen në të gjitha detyrat, që nga


fillimi nuk është bërë asnjë dallim midis dy gjinive në ndarjen e detyrave të sigurisë operative, siç është, për shembull, ajo e përcjelljes së personave të paraburgosur nga DHSK-ja. Në shumë institucione gjyqësore të tjera, kjo nuk është një praktikë e zakonshme. Duke siguruar mbajtjen në ruajtje dhe përcjelljen e sigurt të personave të paraburgosur, ekipet e përcjelljes të Njësisë së Sigurisë luajnë rol kyç në mbështetjen e përditshme të procedurave gjyqësore. Gjithashtu, ekipet e përbashkëta të DHSK-së dhe ZPS-së, të përbëra nga punonjës të sigurisë nga të dy institucionet angazhohen në detyra të ndjeshme në terren.

Sistemi i punës me rotacion është treguar i pazëvendësueshëm për administrimin efikas të kapaciteteve të Njësisë së Sigurisë. Ai është një element kyç në punësimin dhe mbajtjen e punonjësve në tërësi, dhe ka rëndësi të drejtpërdrejtë për punonjësit që kanë fëmijë. Ky sistem mundëson planifikim afatgjatë dhe stabilitet të orarit të punës, që ndihmon në vënien e ekuilibrit midis obligimeve profesionale dhe personale. Komentet e punonjësve për këtë sistem janë mjaft pozitive. Për më tepër, punonjësit i kanë bërë një lloj reklame këtij sistemi, duke ndarë përvojën dhe folur me njerëz në shtetet amë të tyre, çka ka rezultuar në një larmi më të madhe kandidatësh që aplikojnë për vende pune të sigurisë.

Sa i përket përfaqësimit gjinor në përgjithësi, dy nga tre drejtuesit e emëruar, Kryetarja dhe Administratorja, janë gra. Në vitin 2020, u punësuan 65 punonjës të rinj - 51% prej tyre gra dhe 49% burra. Në fund të vitit 2020, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në DHSK dhe ZPS, 38% janë gra dhe 62% burra, krahasuar me 36% gra dhe 64% burra në vitin 2019. DHSK-ja ka 181 punonjës - 45% prej tyre janë gra dhe 55% janë burra. ZPS-ja ka 63 punonjës - 22% prej tyre janë gra dhe 78% janë burra.

Përfaqësimi gjinor në DHSK dhe ZPS

31 dhjetor 2020




Konkretisht, Prokurori i Specializuar ka për synim rritjen e numrit të grave të punësuara në ekipin e sigurisë së operacioneve dhe dëshmitarëve. Së bashku me Administratoren, Prokurori i Specializuar mbajti tryeza të rrumbullakëta me zyrtarë të lartë të sigurisë, në të cilat u diskutuan praktikat më të mira dhe masat që do të kontribuojnë për rritjen e numrit të grave kandidate për vende të lira pune gjatë Ftesave për Aplikime në të ardhmen. Bëhet fjalë për masat e mëposhtme:

- Së bashku me personin e kontaktit për çështje gjinore, të organizohen dhe promovohen aktivitete ku përfaqësues të DHSK-së dhe ZPS-së, gra e burra, do të diskutojnë bashkërisht kulturën organizative në dy institucionet dhe njësitë e tyre, do të ngrenë çështje dhe paraqesin shqetësimet e tyre të mundshme, do të identifikojnë mënyrat për të motivuar kandidatë të profileve sa më të ndryshme që të aplikojnë për vende pune, si dhe do të trajtojnë pengesat në lidhje me mbajtjen e punonjësve.
- Fuqizimi i punës së personit të kontaktit për çështje gjinore përmes nxitjes dhe mbështetjes së punonjësve të DHSK-së dhe ZPS-së që të jenë “ambasadorë” të nismave të DHSK-së dhe ZPS-së për barazi gjinore në kontaktet e tyre me

kolegë/organizata/institucione të mëparshme, me qëllim të përmirësimit të barazisë gjinore në mesin e kandidatëve për vende pune në ZPS dhe eventualisht të rritjes së numrit të punonjësve femra në ekipin e sigurisë së operacioneve dhe dëshmitarëve, si dhe në njësitë e tjera të ZPS-së

Si pjesë e angazhimeve të vazhdueshme diplomatike, drejtuesit vazhdojnë t'i nxisin shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese që të emërojnë kandidatë të kualifikuar për punësim duke mbajtur parasysh barazinë gjinore. Sa i përket vendeve të punës në Njësinë e Sigurisë, drejtuesit vazhdojnë të theksojnë se nuk bëhen dallime në ndarjen e detyrave të sigurisë operative midis punonjësve femra dhe meshkuj, si dhe të sigurojnë shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuese se DHSK-ja dhe ZPS-ja angazhohen fuqimisht për rritjen e numrit të kandidatëve femra për poste në njësitë e tyre të sigurisë dhe përgjithësisht në të dy institucionet.

**Zyra e
Prokurorit të
Specializuar**



1 | Parathënie

Në vitin që shkoi, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) shënoi disa arritje të rëndësishme, përkundër vështirësive që shkaktoi pandemia e COVID-19. Në shkurt dhe prill, ZPS-ja paraqiti aktakuzat e para në Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK). Në shtator, policia e ZPS-së arrestoi të akuzuarin e parë dhe e transferoi në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë. Në nëntor, ZPS-ja paraburgosi katër anëtarë të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) pas konfirmimit nga gjykata të aktakuzës në të cilën ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të përhapura gjerësisht.



Xhek Smith, Prokurori i Specializuar

Këto arritje u realizuan falë përkushtimit të jashtëzakonshëm të personelit të ZPS-së dhe mbështetjes së palëkundur të komunitetit më të gjerë ndërkombëtar. Tani po ecim në mënyrë të vendosur dhe të hapur rrugës drejt arritjes së drejtësisë për viktimat dhe familjet e tyre që kanë pritur 20 vjet nxjerrjen para drejtësisë të atyre që janë më së shumti përgjegjës për krimet brenda mandatit tonë. Këto viktima janë civilë të përkatësive të ndryshme etnike – jo vetëm serbë, por edhe shumë shqiptarë të Kosovës, romë dhe kundërshtarë politikë të të akuzuarve.

Dëshiroj të falënderoj Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe shefin e Misionit, Lars-Gunar Uigemark, për mbështetjen kyçe logjistike dhe operative që i ofruan ZPS-së gjatë vitit të fundit. Falënderoj gjithashtu Bashkimin Evropian, shtetet anëtare të tij, e veçanërisht shtetin pritës Holandën, si edhe shtetet e treta kontribuese, për burimet dhe mbështetjen e tyre që na mundësojnë të kryejmë mandatit tonë.

Dëshiroj gjithashtu t'u shpreh mirënjohjen time kolegëve në DHSK për angazhimin dhe përpjekjet e tyre, veçanërisht Kryetares Ekaterina Trendafilova dhe Administratores Dr. Fidelma Donlon, për krijimin e strukturave dhe procedurave të gjykatës, që bëjnë të mundshme punën tonë.

Xhek Smith
Prokurori i Specializuar

dhjetor, 2020

2 | Zbatimi i mandatit

Gjatë vitit 2020, ZPS-ja paraqiti aktakuzat e para, kreu shtatë arrestime në Kosovë dhe filloi procedimin në tri çështje të veçanta, me gjithë faktin që u detyrua të përshtatë punën e vet në përputhje me rrethanat e krijuara nga pandemia e KOVID-19.

ZPS-ja paraqiti aktakuzat e para në Dhomat e Specializuara në shkurt, pak para vendosjes së masave për parandalimin e përhapjes së KOVID-19, të cilat eventualisht çuan në zbatimin e masave të mbylljes, karantinës e izolimit në pjesën më të madhe të botës, përfshirë Kosovën dhe rajonin më të gjerë. Në mars, ZPS-ja vuri në përdorim mënyra të reja të organizimit të punës në përputhje me praktikën më të mira, për të kufizuar përhapjen e KOVID-19. Në këtë mënyrë, ZPS-ja ishte në gjendje t'u përshtatet rrethanave të reja në Holandë, Kosovë dhe më gjerë në rajon për të vazhduar punën. Pak më pas, përkatësisht në prill, ZPS-ja e paraqiti aktakuzën më të madhe deri më tani.

Në qershor, Prokurori i Specializuar njoftoi se aktakuza e prillit përfshinte presidentin e atëhershëm të Kosovës, Hashim Thaçin, dhe kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veselin. Ai e gjykoji të domosdoshme nxjerrjen e këtij informacioni për shkak të përpjekjeve të përsëritura të z. Thaçi dhe z. Veseli për pengimin dhe sabotimin e punës së DHSK-së.

ZPS-ja e kreu arrestimin e parë më 24 shtator, me arrestimin e Salih Mustafës në Prishtinë dhe transferimin e tij në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë në bazë të fletarrestimit, urdhrin për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar, të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. EULEX-i i ofroi ZPS-së mbështetje kyçe operative dhe logjistike për kryerjen e arrestimit.

Në Aktakuzë, z. Mustafa akuzohet për përgjegjësi penale individuale për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte sipas të drejtës ndërkombëtare. Seanca e paraqitjes së parë të z. Mustafa para gjyqit u mbajt më 28 shtator.

Më 25 shtator, policia e ZPS-së arrestoi në Prishtinë Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn, kryetarin, përkatësisht nënkryetarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Z. Gucati u transferua në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë të njëjtën ditë, kurse z. Haradinaj një ditë më vonë. Hetuesit e ZPS-së gjithashtu kryen kontrollimin e zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së. Këto veprime u kryen në përputhje me fletarrestimet, urdhrat për kryerjen e kontrollimit dhe urdhrat për transferim, të lëshuara nga Gjykatësi i Vetëm. Edhe këto operacione, ZPS-ja i kreu me mbështetjen operative dhe logjistike kyçe të EULEX-it.



*Rreshti i parë, nga e majta në të djathtë: prokurorët Alan Tiger, Kler Loson dhe Dejvid Harbah
Rreshti i dytë, nga e majta në të djathtë: Prokurori i Specializuar Xhek Smith dhe Zëvendësprokurori i Specializuar Aleks Uajting*

Fletarrestimet për z. Gucati dhe z. Haradinaj u lëshuan në bazë të dyshimit se kishin kryer vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatësisht orvatje për frikësimin e dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës. Paraqitja e parë e z. Haradinaj në gjykatë ishte më 29 shtator dhe e z. Gucati më 1 tetor. Aktakuza që u paraqit më pas kundër z. Haradinaj dhe z. Gucati u konfirmua më 11 dhjetor.

Më 4 dhe 5 nëntor, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi u arrestuan dhe u transferuan në objektin e paraburgimit të DHSK-së në Hagë, në bazë të aktakuzës së konfirmuar, fletarrestimeve dhe urdhrave për transferim, të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Gjithashtu, në bazë të urdhrave për kontrollim të lëshuara nga Gjykata, u krye kontrollimi i një numri vendesh banimi që kanë lidhje me të akuzuarit. Përsëri gjatë këtyre operacioneve, EULEX-i siguroi mbështetje kyçe operative dhe logjistike për ZPS-në.

Paraprakisht, në tetor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi të gjitha pikat e aktakuzës së paraqitur kundër z. Thaçi, z. Veseli, z. Selimi dhe z. Krasniqi. Gjykata konfirmoi të gjitha pikat e aktakuzës së paraqitur kundër z. Thaçi dhe të bashkakuarve, duke konstatuar se ekziston dyshim



Aleks Uajting, Zëvendësprokurori i Specializuar

i bazuar mirë që “do të bindte një vëzhgues objektiv që një vepër penale ka ndodhur dhe që është kryer nga i pandehuri.” Gjykata bazoi konstatimin e vet në “material mbështetës konkret dhe të qartë, i cili demonstroi një linjë të qartë arsyetimi mbi të cilën bazohen akuzat në aktakuzë”.

Numri i punonjësve

Në ZPS është parashikuar të ketë 78 vende pune, ku përfshihen prokurorë, këshilltarë juridikë, specialistë të sigurisë, hetues, analistë, specialistë për sigurinë dhe mbrojtjen e dëshmitarëve dhe personel mbështetës. Në fund të vitit 2020, u plotësuan 57 nga ky numër i paraparë për vende pune, përkatësisht 73%, me punonjës nga 19 shtete, si nga shtetet anëtare të BE-së, po ashtu dhe shtetet e treta kontribuese.



Secili prej të akuzuarve akuzohet për përgjegjësi penale individuale për arrestim dhe ndalim të paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme si krime lufte, dhe për burgosje, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, zhdukje me forcë e personave dhe përndjekje, si krime kundër njerëzimit, të kryera së paku nga marsi 1998 deri në shtator 1999.

Z. Krasniqi dhe z. Thaçi patën paraqitjen e parë më 9 nëntor, z. Veseli më 10 nëntor dhe z. Selimi më 11 nëntor.



Prokurorja Valeria Boliçi

Raportimet me videokonferencë

Gjatë vitit 2020, Prokurori i Specializuar Xhek Smith mbajti një sërë raportimesh diplomatike përmes videokonferencës për t'i informuar shtetet anëtare të BE-së dhe shtetet e treta kontribuuese për punën aktuale të ZPS-së, për pengesat me të cilat ajo përballet dhe mënyrat në të cilat bashkësia ndërkombëtare do të mund ta ndihmonte për t'i shpejtuar hetimet.

Prokurori i Specializuar Smith, Kryetarja e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova, dhe Administratorja Dr. Fidelma Donlon, iu drejtuan diplomatëve në Hagë në korrik dhe në dhjetor, kurse atyre me shërbim në Prishtinë në muajin dhjetor.

Mbështetja e komunitetit më të gjerë ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet e rëndësishme kyçe për operacionet e ZPS-së.



3 | Historiku i ZPS-së

ZPS-ja u krijua më 1 shtator 2016 në bazë të amendamentit kushtetues dhe Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 gusht 2015. Ajo e trashëgoi personelin dhe mandatin e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS).

TFHS-ja u krijua në vitin 2011 në Bruksel si njësi brenda EULEX-it, për të hetuar pretendimet e ngritura në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës me titull “Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”, i cili u botua në fillim të vitit 2011.

Raporti i Këshillit të Evropës përmban konstatimet e hetimit të udhëhequr nga senatori zviceran Dik Marti, në lidhje me pretendimet në librin e memoareve të ish-kryeprokurores së Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ) Karla del Ponte të vitit 2008, me titull Zonja Prokurore. Zonja Del Ponte nuk kishte qenë në gjendje të kryente hetime të mëtejshme në TPNJ për shkak se nuk kishte pasur juridiksion.



Memoaret e Del Pontes

Hetimet e TFHS-së u drejtuan nga Klint Uilliamson (Clint Williamson), prokuror nga Shtetet e Bashkuara dhe ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara për çështje të krimeve të luftës.



Ambasadori Klint Uilliamson

Në korrik 2014, ambasadori Klint Uilliamson raportoi se për hetime të mëtejshme duhej të krijoheshin një gjykatë. Si rezultat i kësaj, në gusht 2015, Kuvendi i Kosovës miratoi amendamentin kushtetues dhe Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).

ZPS-ja është institucion i pavarur dhe pavarësia e saj garantohet nga Ligji që e krijoi atë. Rrjedhimisht, ZPS-ja ka detyrimin të veprojë në mënyrë të pavarur nga DHSK-ja dhe nga të gjithë prokurorët e tjerë në Kosovë. Ligji gjithashtu e udhëzon Prokurorin e Specializuar dhe personelin e ZPS-së që të mos kërkojnë e as marrin udhëzime nga ndonjë qeveri apo burim tjetër.

Dejvid Shvendiman, ish prokuror federal i SHBA-së dhe më herët zëvendëskryeprokurore dhe shef i Departamentit Special për Krime Luftë në Bosnje dhe Hercegovinë, u emërua Prokurori i Specializuar i parë më 1 shtator 2016, kur TFHS-ja u transformua në ZPS. Xhek Smith mori postin e Prokurorit të Specializuar në shtator 2018.

4 | Kuadri udhëheqës i Prokurorisë

Në krye të ZPS-së është një ekip prokurorësh me përvojë, të gjithë prej tyre me përvojë para autoriteteve gjyqësore të shteteve të tyre dhe në gjykata ndërkombëtare.

Xhek Smith, prokuror amerikan me përvojë si në hetime politike të nivelit të lartë ashtu edhe në hetime penale ndërkombëtare, mori detyrën e Prokurorit të Specializuar në shtator 2018.

Para se t'i bashkohej ZPS-së, z. Smith ishte zëvendëskryetar dhe shef i seksionit të padive në Korporatën Spitalore të Amerikës, organizata më e madhe joqeveritare e shërbimit shëndetësor në Shtetet e Bashkuara, post të cilin e mbante që prej shtatorit 2017.

Nga shkurti 2015 deri në gusht 2017, z. Smith ishte ndihmësprokuror i parë federal dhe ushtrues i detyrës së prokurorit federal për rajonin e mesëm në shtetin Tenësi (Tennessee).

Gjatë periudhës 2010-2015, z. Smith ishte kreu i seksionit për integritet publik në Departamentin e Drejtësisë të SHBA-së, ku ishte i ngarkuar me mbikëqyrjen e procedimit të çështjeve të ndërlikuara të korrupsionit publik në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

Nga viti 2008 deri më 2010, z. Smith ishte koordinator i hetimeve në Zyrën e Prokurorit në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN). Në atë funksion ai mbikëqyri hetime delikate të zyrtarëve të qeverive dhe pjesëtarëve të forcave milicore të huaja për krime lufte, krime kundër njerëzimit, dhe gjenocid.

Përpara se të merrte detyrën në GJPN, z. Smith punoi në Zyrën e Prokurorit Federal për Rajonin Lindor të Nju Jorkut, ku gjatë nëntë viteve shërbeu në poste të ndryshme, përfshirë atë të kreut të zyrës për paditë penale dhe të zëvendëshefit të seksionit penal. Si kreu i zyrës për padi penale, z. Smith kishte në vartësi rreth 100 prokurorë penalë në një sërë fushash, ndër të cilat korrupsioni publik, terrorizmi, krimet e dhunshme dhe bandat, si edhe krimi ekonomik dhe mashtrimet financiare komplekse.

Përpara marrjes së detyrës së ndihmësprokurorit federal, z. Smith punoi për pesë vjet si ndihmësprokuror rajoni në Zyrën e Prokurorit të Kontesë së Nju Jorkut, ku shërbeu në seksionet e veprave penale seksuale dhe të dhunës në familje.

Gjatë karrierës së tij, z. Smith ka marrë një sërë çmimesh, si Çmimin e Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së SHBA-së; Çmimin e Prokurorit të Përgjithshëm të SHBA-së për Shërbime të Shquara; Çmimin e Shoqatës Federale të Juristëve për prokurorët e rinj federalë; Çmimin Charles Rose të Shoqatës së Rajonit Lindor; Medaljen Henry L. Stimson të Shoqatës së Juristëve të Kontesë së Nju Jorkut; si dhe bursën pasuniversitare Wasserstein të Fakultetit Juridik të Universitetit të Harvardit.

Ai është diplomuar në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe në Universitetin Shtetëror të Nju Jorkut në Oneonta.



Xhek Smith, Prokurori i Specializuar

Zëvendësprokurori i Specializuar është Aleks Uajting (Alex Whiting), prokuror me shtetësi franceze dhe amerikane, me përvojë të gjerë pune në fushën e ndjekjeve penale, si në juridiksione të brendshme, ashtu edhe ndërkombëtare, ku përfshihen periudha pune në Gjykatën Penale Ndërkombëtare (GJPN) dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), si edhe me një karrierë të shquar akademike.

Z. Uajting, i diplomuar në Kolegjin dhe Fakultetin e Drejtësisë të Jeilit (Yale), erdhi në ZPS-së nga Fakulteti i Drejtësisë i Universitetit të Harvardit, ku kishte punuar si profesor i praktikës juridike që prej vitit 2013.

Z. Uajting punoi në Zyrën e Prokurorit të GJPN-së nga 2010 deri në 2013, fillimisht si koordinatör i hetimeve, i ngarkuar me mbikëqyrjen e të gjitha hetimeve, dhe më pas si koordinatör i procedimeve, përgjegjës për mbikëqyrjen e të gjitha procedimeve penale.

Në TPNJ, ku punoi nga 2002 në 2007, z. Uajting ishte kryeprokuror në gjykimin e Fatmir Limajt, Isak Musliut, dhe Haradin Balës, dhe kryeprokuror në gjykimet e Millan Martiqit dhe Dragomir Millosheviqit.

Përpara punës në TPNJ, z. Uajting ishte prokuror federal në SHBA, së pari në Seksionin Penal të Departamentit të Drejtave Civile në Uashington dhe më pas në Zyrën e Prokurorit të Shteteve të Bashkuara në Boston, Masaçusets (Massachusetts), ku u mor me çështje të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Alan Tiger (Alan Tieger) është Prokuror i lartë i ZPS-së, me shtetësi amerikane dhe përvojë të gjerë në SHBA dhe në TPNJ. Z. Tiger punoi si në gjykimin e parë në TPNJ – në gjykimin e Dushko Tadiqit, po ashtu edhe në gjykimin e fundit në atë institucion – në gjykimin e Ratko Mlladiqit. Ai ishte prokuror i lartë edhe në gjykimet e Ante Gotovinës, Radovan Karaxhiqit, Momçillo Krajishnikut, Darko Mërgjës dhe Biljana Pllavshiqit.

Zoti Tiger ka punuar si prokuror federal në Seksionin Penal të Departamentit të Drejtave Civile në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara nga 1987 deri në 1994, ku procedoi çështje të dhunës racore dhe brutalitetit policor në të gjithë vendin, përfshirë çështjen e Rodni Kingut (Rodney King).

Ai u diplomua në Universitetin e Kalifornisë në Los Anxheles ndërsa studimet e doktoraturës në fushën e drejtësisë i përfundoi në Universitetin e Santa Klarës.



Aleks Uajting, Zëvendësprokuror i Specializuar



Alan Tiger, Prokuror i lartë

Kler Loson (Clare Lawson) është shefe e ekipit juridik këshillimor. Z. Loson, me shtetësi irlandeze, u diplomua në Kolegjin e Universitetit të Dublinit, kreu një vit specializim në fushën e të drejtës ndërkombëtare në Universitetin e Melburnit dhe mori titullin e magjistratit të drejtësisë në Universitetin e Kolumbias. Përpara se të fillonte punën në ZPS, z. Loson punoi si juriste në Seksionin Gjyqësor të GJPN-së, në Zyrën e Prokurorisë së TPNJ-së, si këshilltare e të drejtave të njeriut në qeverinë irlandeze, dhe si avokate në një firmë ligjore të shquar irlandeze.

Zonja Loson ka punuar në një numër çështjesh penale ndërkombëtare, ndër të tjera në ato që kanë të bëjnë me Republikën e Afrikës Qendrore, Republikën Demokratike të Kongos, Kenian dhe ish-Jugosllavinë. Ajo ka kryesuar gjithashtu negociata për të drejtat e njeriut në emër të BE-së dhe në OKB.



Kler Loson, Shefe e ekipit juridik këshillimor







DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E
PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS

DHOMAT E SPECIALIZUARA DHE ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR TË KOSOVËS RAPORTI I VITIT 2020

Botuar dhe shpërndarë nga:

Dhomat e Specializuara të Kosovës (DHSK)

Botuar në tri gjuhë:

Anglishte, shqipe, serbishte

Për më shumë informacion, vizitoni faqen e Internetit të DHSK-së:

www.scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Dhomat e Specializuara të Kosovës:

mediaKSC@scp-ks.org

Për pyetje nga mediat në lidhje me Zyrën e Prokurorit të Specializuar:

spokespersonSPO@scp-ks.org

Paraqitja grafike:

Wim Jansen Design

www.wimjansendesign.nl

Shtypur nga

Quantes Grafimedia

www.quant.es.nl

**E drejta e autorit- © 2021 Dhomat e Specializuara
dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës.**

Të gjitha të drejtat të rezervuara.



www.scp-ks.org